

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5786
E shtunë, 25 maj 2019
çmimi 0.40 €

Kryetarët e zgjedhur serbë në veri sërish paralajmërojnë dorëheqje



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

META OFROI SHANSIN PËR ZGJIDHJEN E KRIZËS POLITIKE BRENDA VENDIT

Prof. Lisen BASHKURTI



AKTUALE

LARGIMI I PËRLOTUR I KRYEMINISTRES BRITANIKE THERESA MAY



KGJK-ja PRANOI TRI TELEFONATA KËRCËNUESE ME BOMBË, POLICIA NUK GJEN ASGJË TË DYSHIMTË

EKONOMI

HARADINAJ: INFRASTRUKTURA E BËN KOSOVËN MË ATRAKTIVE PËR SIPËRMARRËSIT DHE PËR INVESTITORËT

KULTURË

SHQYRTOHET MUNDËSIA QË NXËNËSIT TË DËRGOHEN DY HERË BRENDA VITIT NË TEATËR

SPORT

'EPOKA E RE' SIGURON TITULLIN NË MEDIA LIGË



FLET PËR "EPOKËN E RE", IBRAHIM GASHI

Shpresoj që refuzimi i opozitës për tribunalin të jetë i përkohshëm



Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka ftuar spektrin politik që të bashkohet rreth themelimit të tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për

gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo çështje është përgjegjësi e të gjithë përfaqësuesve të popullit. Gashi ka deklaruar se nuk dëshiron të besojë se në të ardhmen ndonjë subjekt politik shqiptar nuk do ta

mbështeste idenë e krijimit të këtij tribunal. Sipas tij, lobimi i mirë pranë shteteve dhe organizatave ndërkombëtare më me ndikim do të mund të ndihmonte në sensibilizimin e nevojës për ngritjen e një gjykate të tillë

Analistët: Opozita e ka problem t'i sigurojë votat për rrëzimin e qeverisë

Njohësit e proceseve politike, Imer Mushkolaj dhe Behxhet Shala, kanë vlerësuar se opozita e ka të vështirë t'i sigurojë votat për rrëzimin e qeverisë. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se aktualisht opozita nuk është në gjendje ta

rrëzikojë seriozisht pushtetin. Prandaj, sipas tyre, iniciativa e opozitës mund të mos japë rezultat. Mushkolaj dhe Shala kanë deklaruar se ambicia për pushtet ka bërë që Mustafa dhe Kurti ta harrojnë të kaluarën dhe t'i shkelin parimet



Prokuroria e Pejës ngrre 20 aktakuza për statusin e dyshuar të veteranëve



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kryetarët e zgjedhur serbë në veri sërish paralajmërojnë dorëheqje

Kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiq, ka thënë të premten në Beograd, se kryetarët e zgjedhur të komunave të veriut të Kosovës, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore, janë të gatshëm të japin sërish dorëheqje. Këtë qëndrim ai e ka paraqitur pas takimit që ka pasur me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Ndaj këtij paralajmërimi kanë reaguuar edhe përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, të cilët kanë theksuar se kërcënimi për dorëheqje është një akt i pahijshëm dhe i dëmshëm që cenon bashkëjetesën dhe stabilitetin e Kosovës

**EPOKA E RE**

Qendresa RAMA

BEOGRAD, 24 MAJ - Kryetari i Listës Serbe, Goran Rakiq, ka thënë të premten se kryetarët e zgjedhur të komunave të veriut janë të gatshëm prapë të japin dorëheqje. Këtë deklaratë Rakiq e ka dhënë pas takimit që kanë pasur në Beograd përfaqësuesit serbë të komunave veriore me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq. Rakiqi ka thënë se janë të gatshëm që sërish t'i lënë institucionet nëse nuk ka mirëkuptim

nga Prishtina por kjo, sipas tij, do të ndodhë në të gjitha nivelet nga prokuroritë dhe gjykatat.

Në takimin me presidentin e Serbisë, Vuçiq, pos liderit të Listës Serbe, Goran Rakiq, kanë qenë të pranishëm edhe nënkryetari i kësaj partie, Dalibor Jevtiq, si dhe Milan Radojčić, i cili kërkohet nga autoritetet e Kosovës për shkak të dyshimit për përfshirjen e tij në rastin e vrasjes së politikanit serb Oliver Ivanoviq në janar të vitit 2018.

Vuçiqi i ka komentuar edhe paralajmërimet se fituesit e

zgjedhjeve për kryetar të katër komunave të veriut të Kosovës, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë Veriore, janë të gatshëm të japin sërish dorëheqje. "U kam thënë që ta bëjnë punën e tyre dhe të mos nguten. Ne po përgatitemi që t'ju njoftojmë me vendimet tona pas Parisit. Unë e di që plot njerëz në Kosovë i presin gabimet tona fatale në mënyrë që ta kapin veriun", ka thënë Vuçiqi.

Haradinaj, Vuçiqit: Është koha t'i prezantosh vlerat evropiane

Rreth deklaratave të Vuçiqit për Kosovën ka reaguuar edhe kryeministri Ramush Haradinaj, i cili ka thënë se presidenti serb duhet të reflektojë. "Reflekto, z. Vuçiq! Është koha të prezantosh vlera evropiane dhe jo qëndrime të cilat i ke prezantuar në të kaluarën, qëndrime këto që kanë shkaktuar tragjedi dhe dhimbje. Shteti i Kosovës është edhe shteti i serbëve të Kosovës, një shoqëri që ne e ndajmë së bashku. Neve na duhet shpresë dhe Kosova është gati për marrëveshje me të cilën pranohet realiteti i dy shteteve, në kufijtë ekzistues dhe respekt reciprok", ka thënë Haradinaj.

Vuçiqi ka thënë se me përfaqësuesit e serbëve të Kosovës ka biseduar për masat që shteti i

Serbisë do t'i zbatojë në rast se Qeveria e Kosovës nuk e heq taksën ndaj mallrave të Serbisë. "Kemi përgatitur masat dhe do të shohim që ato masa të mos i godasin serbët e Kosovës. Për këtë shkak, ato masa janë me karakter të kufizuar, por disa masa që i kemi përgatitur janë tepër të fuqishme dhe të mprehta. Nuk do t'i zbatojmë ato deri në përfundimin e takimit në Paris. Detyra ime në Paris është që t'i njoftoj përfaqësuesit e Evropës, pra Gjermaninë, Francën dhe kancelaren Merkel dhe presidentin Macron, për përgjigjen e Serbisë pas nëntë muajve të taksave anticivilizuese dhe të paligjshme", është shprehur Vuçiqi.

Ndërkaq Marko Gjuriq, shef i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, ka theksuar se kryetarët e zgjedhur të komunave të veriut do t'i ushtrjnë funksionet e tyre derisa nuk paraqiten pengesat për ta. "Kjo do të ndodhë vetëm deri në qoftë se nuk pasojnë presionet e reja politike, ekonomike dhe të sigurisë, të cilat veprimin e tyre në ato pozita do ta bënin të pakuptimtë. Në atë rast, natyrisht se ata do t'i braktisin pozitat e tyre", ka thënë Gjuriqi.

Veseli: Paralajmërimi i dorëheqjes nga kryetarët e veriut, akt i pahijshëm

Ndaj paralajmërimin të kryetarëve të sapozgjedhur të komunave të veriut të Kosovës, se mund të japin dorëheqje, ka reaguuar kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli. Ai ka thënë se paralajmërimi i dorëheqjes nga kryetarët e sapozgjedhur të komunave të veriut të Kosovës është një akt i pahijshëm dhe i dëmshëm që cenon bashkëjetesën dhe stabilitetin e Kosovës. "Kjo deklaratë e dhënë prej tyre, pas

takimit me presidentin serb Aleksandër Vuçiq, dëshmon edhe njëherë qartazi mungesën e vullnetit të Beogradit për të ndërtuar paqe dhe fqinjësi të mirë. Me këtë rast, u bëj thirrje përfaqësuesve të Bashkimit Evropian dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë, që ta bëjnë detyrën e marrë përsipër si garantues për të bërë presion në mënyrë që Serbia t'i zbatojë marrëveshjet e nënshkruara në

Bruksel", ka thënë Veseli në deklaratën e tij për media. Ai ka thënë se, pavarësisht prej këtyre provokimeve, Republika e Kosovës është një shtet model në mbarë Evropën sa i përket garantimit të të drejtave të komuniteteve joshumicë dhe do të vazhdojë me këmbëngulje që me procesin e dialogut final t'i zgjidhë problemet e së kaluarës me Serbinë duke siguruar njohjen dhe ulësen në OKB.

Basha: Rama, po të kishte pak nder, do të ishte larguar

TIRANË, 24 MAJ - Në takimin e tij me qytetarët e Matit, një ditë para protestës së gjashtë kombëtare të opozitës së bashkuar, Basha është shprehur se, nëse Edi Rama do të kishte pak moral, ashtu si kryeministrat në botë, sot do të duhej të largohej disa herë. "Prej gjashtë vjetësh thika e së keqes ka shkuar në palcën e çdo shqiptari. Që gjashtë vjetë litari është shtrenguar, taksat urritën, kostot e jetës u bënë të papërballueshme, padrejtësia u bë e madhe. Njerëzit që nuk pranuan fatin e padrejtësisë u burgosën, kurse politikanët e korruptuar me koncesionet, me tenderët

më të tmerrshme që ka njohur Evropa, nuk shkuan përpara drejtësisë, sepse Rama e kapi drejtësinë për t'i mbyllur dosjet e korrupsionit.

Edi Rama po të kishte pasur një të mjitën e nderit të Tereza May apo Sebastian Kurz do të ishte larguar me mijëra herë. Do të ishte larguar kur u zbulua se solli në parlament kriminelë, vrasës dhe përdhunues. Do të ishte larguar kur ylli i tij, Saimir Tahiri, u kap me trafikantët e drogës, kur Damian Gjoknuri u kap vjedhje pas vjedhjeje dhe me qindra milionë në skandalin e Unat. Do të ishte larguar

kur ylli i tij, Saimir Tahiri, u zbulua që me trafikantët e drogës, kur Dmanin Gjoknuri u kap vjedhje pas vjedhje duke vjedhur qindra milionë euro me skandalin e Unazës apo OSShE. Duhet të ishte larguar kur me kryekriminelin Ylmer Lala vodhi zgjedhjet në Dibër. Duhet të ishte larguar kur Vangjush Dako u kap duke blerë votat. Duhet të ishte larguar kur u zbulua afëra e Unazës së Re. Duhet të ishte larguar kur helmoi fëmijët me gaz. Por Rama nuk ka as një të mjitën e nderit dhe të dinjitetit të kryeministrave në botë", u shpreh Basha.

**EPOKA E RE**

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Analistët: Opozita e ka problem t'i sigurojë votat për rrëzimin e qeverisë

Njohësit e proceseve politike, Imer Mushkolaj dhe Behxhet Shala, kanë vlerësuar se opozita e ka të vështirë që t'i sigurojë votat për rrëzimin e qeverisë. Ata kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se aktualisht opozita nuk është në gjendje që ta rrezikojë seriozisht pushtetin. Prandaj, sipas tyre, iniciativa e opozitës mund të mos japë rezultat. Mushkolaj dhe Shala kanë deklaruar se ambicia për pushtet ka bërë që Mustafa dhe Kurti ta harrojnë të kaluarën dhe t'i shkelin parimet

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 24 MAJ - Analisti politik Imer Mushkolaj e ka quajtur të pamundur iniciativën e dy partive opozitare, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe Lëvizjes Vetëvendosje (LV), për rrëzimin e qeverisë në rast se disa vota nuk sigurohen nga tabori i koalicionit në pushtet. Ai ka thënë se kjo iniciativë duket e dyshimtë meqë këto dy parti nuk po tregohen të sinqerta se nga do t'i sigurojnë votat e mjaftueshme. "Iniciativa e dy partive më të mëdha opozitare për rrëzimin e qeverisë është e pamundur në

rast se nuk sigurohen edhe disa vota nga koalicioni qeverisës. Është interesante se kjo iniciativë ka ardhur pikërisht në këtë kohë, ani pse është bërë më shumë se një vit prej se kemi këtë qeveri dhe këtë mënyrë të qeverisjes së kryeministrit Haradinaj. Deri më tani as LDK-ja dhe as Vetëvendosja nuk kanë bërë diçka konkrete në këtë drejtim. Megjithatë, kjo duket shumë e dyshimtë sepse LDK-ja dhe LV-ja duhet të tregohen më të sinqerta dhe të tregojnë se me çfarë votash dhe si do t'i sigurojnë votat për ta rrëzuar qeverinë aktuale. Pra, nga kush synojnë t'i marrin votat e mjaftueshme", ka

deklaruar Mushkolaj të premten për gazetën "Epoka e re". Sipas tij, ambicia për pushtet ka bërë që Mustafa e Kurti ta harrojnë të kaluarën dhe t'i shkelin parimet. "Edhe Mustafa edhe Kurti si duket i kanë harruar parimet dhe të kaluarën ndërmjet vete. Tash për Kurtin, Mustafa nuk është argat i Serbisë dhe për Mustafën, Kurti nuk është gomar i 'Zajednicës'. Ata i kanë humbur parimet apo po i shkelin ato për shkak të ambicies për të ardhur në pushtet. Ani pse ata po thonë se këtë po e bëjnë për të mirën e vendit dhe për ta rrëzuar një qeverisje të keqe", është shprehur Mushkolaj. Sidoqoftë, ai ka vlerësuar se kjo iniciativë do t'i shërbejë liderit të LDK-së, Isa Mustafa, për ta fuqizuar pozicionin e tij tash në prag të mbajtjes së zgjedhjeve si dhe Kurtit pas sondazheve të fundit. Edhe analisti tjetër politik, Behxhet Shala, ka thënë të premten për gazetën "Epoka e re" se opozita e ka problem që t'i sigurojë votat për rrëzimin e qeverisë. "E vetmja gjë që ka bërë

opozita deri më tani ka qenë sigurimi i votave për pushtetin dhe nuk ka arritur të bëjë asgjë për rrëzimin e qeverisë. Opozita nuk po ka sukses dhe e ka problem që t'i sigurojë votat e mjaftueshme, sepse PSD-ja po thotë se nuk pranon ta rrëzojë qeverinë me votat e Listës Serbe. Edhe brenda Vetëvendosjes ka të atillë që e mendojnë të njëjtën gjë. Sikurse që edhe LDK-ja ka pasur më herët këtë qëndrim. Në këto rrethana nuk ka ku t'i marrë votat e mjaftueshme. Aktualisht i kanë 56 vota, prandaj uu duhen edhe pesë të tjera. Pesë vota janë shumë dhe është problem që të gjenden", ka deklaruar ai, duke shtuar se nëse shpresohet që këto vota t'i marrin nga koalicioni qeverisës, sipas Shalës, partitë në pushtet nuk janë të interesuara që ta rrëzojnë vetën. "Po të kishte një interesim të tillë koalicioni qeverisës tashmë do ta kishte rrëzuar vetën dhe nuk do ta priste opozitën. Qeverinë aktuale mund ta rrëzojë presidenti Thaçi dhe PDK-ja. Tani për tani nuk shoh lëvizje drejt shkuarjes në zgjedhje. Në kohën kur po flitet për arritjen e

një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk besoj se investimi i ndërkombëtarëve do të lejojë zgjedhje. Ndoshta mund të flitet për zgjedhje në vjeshtën e largët, edhe pse është pak e besueshme", është shprehur Shala.

Ai ka vlerësuar se opozita aktuale nuk është në gjendje që ta rrezikojë seriozisht pushtetin. "Që nga formimi dhe votimi në Kuvend, qeveria Haradinaj ka qenë në këmbë të qelqta dhe po bëhen gati dy vjet të funksionimit të saj. Prandaj iniciativa e opozitës nuk besoj se do të japë farë rezultati. Sipas mendimit tim, opozita nuk është në gjendje ta rrezikojë seriozisht pushtetin", ka theksuar Shala. Megjithatë, sipas Shalës, edhe nëse do të ndodhë një gjë e tillë, LDK-ja dhe LV-ja do ta kenë problem ndarjen e pushtetit dhe postin e kryeministrit. "LDK-ja dhe LV-ja nuk kanë asgjë të përbashkët, pra nuk i lidh asnjë pikë e vetme përveç pushtetit. Ardhja në pushtet i ka bërë këto dy parti dhe liderët e saj që ta harrojnë të kaluarën dhe parimet. Ata i bashkon pushteti, por edhe nëse veç ndodh një gjë e tillë, Kurti dhe Mustafa do ta kenë problem krijimin e qeverisë, ndarjen e ministrive si dhe postin e kryeministrit", ka thënë ai.

Sipas Shalës, në rrethanat aktuale më së shumti do të fitonte AAK-ja dhe kryeministri Haradinaj për faktin se gabimet e të tjerëve dhe këmbëngulja për të mos bërë lëshime përballë Serbisë e ka forcuar shumë. "Gjithashtu, sipas vlerësimit tim, edhe nëse hipotetishtë e marrin pushtetin LV-ja dhe LDK-ja, nuk do të fitonin asgjë për faktin se as teorikisht nuk do të mundnin ta ndryshonin situatën brenda një mandati qeverisës. Nëse koalicioni qeverisës nuk plasaritet aktualisht, opozita nuk është pykë që mund ta çajë atë. LV-ja do zgjedhje sepse beson në rezultat të mirë në sondazhin që e ka bërë vetë. E keqja e Kosovës është se nuk ka alternative politike dhe se në lojë janë dinozaurët që iu ka kaluar afati i përdorimit", ka thënë Shala.



Veseli pret studentët që i dhanë përkrahje për tribunalin

Prishtinë, 24 maj (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të premten në takim një grup studentësh përfaqësues të të gjitha universiteteve publike të cilët i ka falënderuar për mbështetjen e iniciativës për zbardhjen e krimeve të gjenocidit serb. Ai ka thënë se Kosova ka ecur përpara çdoherë

që të rinjtë kanë marrë rolin për transformimin dhe zhvillimin e vendit. "Pata kënaqësinë të pres në takim një grup studentësh përfaqësues të të gjitha universiteteve tona publike. I falënderova për mbështetjen që treguan për iniciativën time për zbardhjen e krimeve të gjenocidit serb dhe vënien e krim-

inelëve përpara drejtësisë ndërkombëtare. Bashkëbisedimi me të rinjtë gjithmonë është frymëzues dhe produktiv. Kosova ka ecur përpara çdoherë që të rinjtë kanë marrë rolin që natyrshëm u takon: rolin e transformimit dhe zhvillimit", ka thënë Veseli pas takimit me studentët.



Flet për "Epokën e re", Ibrahim Gashi

Shpresoj që refuzimi i opozitës për



Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka ftuar spektrin politik që të bashkohet rreth themelimit të tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo çështje është përgjegjësi e të gjithë përfaqësuesve të popullit. Gashi ka deklaruar se nuk dëshiron të besojë se në të ardhmen ndonjë subjekt politik shqiptar nuk do ta mbështeste idenë e krijimit të këtij tribunal. Sipas tij, lobimi i mirë pranë shteteve dhe organizatave ndërkombëtare më me ndikim do të mund të ndihmonte në sensibilizimin e nevojës për ngritjen e një gjykate të tillë

dëshmitarët dhe gjykatat vendore, duke zbuluar dhe ngritur padi për kriminelët, qoftë edhe në mungesë (sepse një pjesë e madhe e kriminelëve potencialë serbë janë të lirë dhe gjenden në Serbi, madje edhe në institucione atje) do ta sensibilizonte drejtësinë ndërkombëtare për nevojën e ngritjes së një tribunalit të tillë", është shprehur Gashi.

Ai ka folur edhe për procesin e dialogut Kosovë - Serbi, duke thënë se ky proces duhet të vazhdojë pa kushtëzime. Sipas Gashit, Samiti i Berlinit ka qenë një impuls i ri dhe vëmendje e shtuar e dy vendeve më të fuqishme për procesin e dialogut. "Pozicioni i largët i palëve dhe pafuqia e znj. Mogerini detyruan ndërhyrjen gjermano-frënge për ta shpëtuar procesin e dialogut që kishte filluar të stërkeqej dhe largohej nga synimi i tij final, arritja e një marrëveshje ligjërish të obligueshme për palët që i hap rrugë normalizimit dhe njohjes reciproke mes dy shteteve. Pres që Samiti i Parisit të dalë me një itinerar konkret për rrjedhën e

dialogut", ka thënë Gashi.

"Epoka e re": Profesor, 20 vjet pas luftës institucionet e Kosovës kanë filluar të tregohen më aktive në raport me krimet serbe. Kuvendi ka miratuar rezolutën për gjenocidin serb në Kosovë, ndërsa kryeparlamentari Kadri Veseli ka filluar iniciativën për themelimin e një tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Çfarë do të thonë për Kosovën këto përpjekje?

Gashi: Nisma për të ndriçuar dhe kërkuar llogari për krimet serbe të kryera në Kosovë ka qenë dhe është e domosdoshme, por sigurisht është dashur të vijë shumë herët. Sidoqoftë, ajo duhet mbështetur me gjithë mundësinë që kemi, si institucione dhe si individë. Rezoluta e miratuar e Kuvendit është vetëm një legjitimim i këtij problemi dhe iniciativë për ta zgjidhur atë. Iniciativa e kryeparlamentarit Veseli është në funksion të realizimit të kësaj rezolute. Kërkesa e zotit Veseli është jashtëzakonisht e rëndësishme. Kosova në

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 24 MAJ - Profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, ka bërë me dije që klasa politike duhet të jetë unike në raport me themelimin e tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. Ai ka thënë se kjo çështje është përgjegjësi e të gjithë përfaqësuesve të popullit, pushtetit dhe opozitës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Gashi ka deklaruar se shpreson që refuzimi i LDK-së dhe LV-së

për themelimin e këtij tribunalit të jetë i përkohshëm. "E kam thënë edhe një herë që për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shtetndërtimin, përgjegjësia është e të gjithë përfaqësuesve të popullit, pavarësisht janë në pushtet apo në opozitë. Nuk dua të besoj se në të ardhmen ndonjë subjekt politik shqiptar apo politikan individualisht nuk do ta mbështeste idenë e krijimit të këtij tribunal. Shpresoj se është refuzim i përkohshëm", ka thënë Gashi. Ai ka treguar se nuk do të jetë e lehtë arritja e këtij qëllimi teksa

u ka rekomanduar institucioneve se çka duhet të bëjnë për të arritur deri te themelimi i tribunalit ndërkombëtar për krimet serbe në Kosovë. "Një lobim i mirë pranë shteteve dhe organizatave ndërkombëtare me ndikim do të mund të ndihmonte në sensibilizimin e nevojës për ngritjen e një tribunalit të tillë", ka thënë ai, duke shtuar se edhe gjykatat vendore, duke i dënua kriminelët serbë në mungesë, do ta sensibilizonin opinionin ndërkombëtar për krijimin e një tribunalit të tillë. "Ndoshta

tribunalin të jetë i përkohshëm

janë gjasat që të ndodhë një tribunal i tillë dhe çka duhet të bëjnë institucionet tona për ta arritur këtë qëllim?

Gashi: Nuk është e lehtë të arrihet një gjë e tillë, aq më pak kur ka kaluar një kohë dhe fokusi i politikës ndërkombëtare nuk është shumë i përqendruar në Kosovë sikundër ka qenë gjatë dhe menjëherë pas luftës. Një lobim i mirë pranë shteteve dhe organizatave ndërkombëtare më me ndikim do të mund të ndihmonte në sensibilizimin e nevojës për ngritjen e një tribunali të tillë. Ndoshta dëshmitarët dhe gjykatat vendore, duke zbuluar dhe ngritur padi për kriminelët qoftë edhe në mungesë (sepse një pjesë e madhe e kriminelëve potencialë serbë janë të lirë dhe gjenden në Serbi, madje edhe në institucione atje), do ta sensibilizonte drejtësinë ndërkombëtare për nevojën e ngritjes së një tribunali të tillë.

"Epoka e re": Sikur në shumë tema të tjera, spektri politik nuk është unik as në këtë çështje. Dy subjektet më të mëdha opozitare e kanë lëshuar seancën e Kuvendit kur është diskutuar për tribunalin. Sa është i rëndësishëm uniteti i faktorit politik për këtë çështje?

Gashi: E kam thënë edhe një herë, që për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shtetndërtimin, përgjegjësia është e të gjithë përfaqësuesve të popullit, pavarësisht janë në pushtet apo në opozitë. Nuk dua të besoj se në të ardhmen ndonjë subjekt politik shqiptar apo politikan individualisht nuk do ta mbështeste idenë e krijimit të këtij tribunali. Shpresoj se është refuzim i përkohshëm.

"Epoka e re": Spektri politik nuk është unik as rreth fazës finale të dialogut me Serbinë. Presidenti dhe kryeministri shpeshherë kanë dallim për këtë fazë të dialogut. Po dëmtohet Kosova me këtë qasje në këtë proces?

Gashi: Dialogu, mendoj unë,

duhet vazhduar, por assesit i kushtëzuar në çfarëdo forme qoftë nga pala serbe. Dallimet mund të jenë në fazën përgatitore në qasje dhe strategji, por assesit në përmbajtje dhe përballë palës serbe.

"Epoka e re": A ka ndryshuar diçka procesi i dialogut Kosovë - Serbi nga Samiti i Berlinit dhe

cilat janë pritjet e juaja nga Samiti i Parisit ku do të diskutohet vetëm për këtë çështje?

Gashi: Mendoj se Samiti i Berlinit është një impuls i ri dhe vëmendje e shtuar e dy vendeve më të fuqishme për procesin e dialogut. Pozicioni i largët i palëve dhe pafuqia e znj. Mogerini detyruan ndërhyrjen gjermano-frënge

për ta shpëtuar procesin e dialogut që kishte filluar të stërkeqej dhe largohej nga synimi i tij final, arritja e një marrëveshje ligjërish të obligueshme për palët që i hap rrugë normalizimit dhe njohjes reciproke mes dy shteteve. Pres që Samiti i Parisit të dalë me një itinerar konkret për rrjedhën e dialogut.

KGJK-ja pranoi tri telefonata kërcënuese me bombë, policia nuk gjen asgjë të dyshimtë

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 MAJ - Të premten rreth orës 10:30 në zyrën e pranimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës janë pranuar tri thirrje telefonike. Në këto thirrje telefonike është lajmëruar një person mashkull i cili ka kanosur me vendosje të mjetit shpërthyes në drejtësinë, konkretisht Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Pas këtyre thirrjeve telefonike, Policia e Kosovës ka ndërmarrë të gjitha veprimet operative dhe hetimore

duke bërë sigurimin e vendit të ngjarjes, duke bërë evakuimin e personelit, njoftimin e njësive të specializuara, duke përfshirë njësitin e materieve shpërthyes dhe njoftimin e prokurorisë kompetente.

Policia ka kontrolluar të dy ndërtesat, ndërtesën e Këshillit Gjyqësor dhe ndërtesën e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. "Nga të gjitha veprimet operative dhe hetimore që ka ndërmarrë Policia e Kosovës, nuk ka rezultuar me të gjetur të ndonjë mjeti të dyshuar dhe rreth orës 15:00 është liru vendi i ngjarjes dhe rruga për qarkullimin e këmbësorëve dhe

automjeteve. Sa i përket identifikimit të personit të dyshuar i cili ka kryer kanosjen me mjet shpërthyes, Policia e Kosovës është duke punuar intensivisht për identifikimin e personit dhe abonuesit të numrit të telefonit nga i cili është kryer kanosja. Në vazhdim, Policia e Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, është duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të identifikimit të personit/personave të dyshuar dhe procedimin e tyre para organeve të drejtësisë", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.



procesin e krimeve të luftës së fundit në Kosovë, pothuaj që nga paslufta, është vënë padrejtësisht në pozicionin vetëm të jap llogari për krime të pabëra. Nisma e zotit Veseli është hapi i parë që Kosova, si viktima potenciale e luftës (1998-1999), të kërkojë llogari nga pala serbe për krimet e bëra, e të dëshmuara katërçipërisht me mijëra varre e viktima të mbijetuara.

"Epoka e re": Si njohës i marrëdhënieve ndërkombëtare, sa

Prokuroria e Pejës ngre 20 aktakuza për statusin e dyshuar të veteranëve

PEJË, 24 MAJ (ER) - Prokuroria Themelore e Pejës ka bërë me dije se deri më tash janë ngritur 20 aktakuza kundër 21 personave për veteranët të cilët dyshohet se kanë mashtruar me dokumente të falsifikuara ashtu që ta fitojnë statusin e veteranit. Prokurorja Lumturije Vuçetaj ka thënë në një konferencë për media në Pejë, se deri tani kanë hetuar rreth 800 nga gjithsej 7 830 dosje që ka pranuar nga

Prokuroria Speciale e Kosovës. Vuçetaj ka thënë se Prokuroria do ta vazhdojë hetimin e secilit rast në mënyrë individuale. "Hetimi ynë i deritanishëm, i cili do të rezultojë edhe me hetime të tjera, konsiston se do të ketë kallëzime penale shtesë dhe në këtë kontest, përveç ngritjes së 20 aktakuzave, jemi duke hetuar edhe raste të tjera, por që marrin kohë", është shprehur Vuçetaj. Sipas saj, nga hetimet bëra,

certifikatat mbi statusin e veteranit të luftës dhe dokumentet për vërtetimin e statusit të veteranit janë rastet më të shpeshta të falsifikimit. Lidhur me këto raste, në vitin 2018, prokurori Elez Blakaj pati dhënë dorëheqje. Ai është thënë se ka pranuar kërcënime sa ka qenë duke hetuar disa raste të dyshuara për manipulime me listat e veteranëve të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.



Limaj në Malishevë: Nisma Socialdemokrate po fuqizohet

"Partia jonë po rritet dhe po fuqizohet. Sondazhet më kredibile flasin për një rritje të konsiderueshme të Nismës. Partia tani është rritur dhe po kalon në nivel tjetër. Për këtë më meritoret jeni ju", ka thënë kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, në takimim që ka pasur me përfaqësues të kësaj partie në Malishevë

MALISHEVË, 24 MAJ (ER) - Nisma Socialdemokrate, dega në Malishevë, ka mbajtur mbledhjen e radhës të kryesisë. Në këtë mbledhje ishte i pranishëm edhe kryetari i këtij subjekti, Fatmir Limaj. Ky i fundit i ka njoftuar drejtuesit e Degës së Nismës në Malishevë për zhvillimet aktuale politike në vend si dhe për vizitën e tij zyrtare në Berlin. Sa i përket Nismës, Limaj ka thënë se partia që drejton tanimë ka kaluar në nivel tjetër dhe sondazhet e konfirmojnë këtë.

Ai i ka falënderuar strukturat e Nismës në Malishevë për punën dhe angazhimin e tyre në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve të kësaj komune si dhe fuqizimit të partisë. "Partia jonë po rritet dhe po fuqizohet. Sondazhet më kredibile flasin për një rritje të konsiderueshme

të Nismës. Partia tani është rritur dhe po kalon në nivel tjetër. Për këtë më meritoret jeni ju", ka thënë Limaj.

Limaj u njoftua nga drejtuesit e Degës së Nismës në Malishevë se po i bashkohen çdo ditë intelektualë të shquar të kësaj komune, si dhe qytetarë të shtresave e gjinive të ndryshme. "Për pesë vjet tanimë është dëshmuar se sa i drejtë ka qenë vendimi për themelimin e Nismës. Qytetarët e Malishevës është dëshmuar se kanë pasur të drejtë kur e kanë mbështetur Nismën Socialdemokrate", është shprehur Limaj. Ai i ka ftuar strukturat e Nismës në Malishevë ta zgjerojnë frymën e Nismës Socialdemokrate në çdo lagje të Malishevës.

Limaj ka theksuar se malishevasit gjithmonë në çaste të rëndësishme kanë ditur të rreshtohen



drejt. Nisma, sipas tij, është shtëpia e të gjithë qytetarëve të Malishevës.

Më tutje, Limaj ka përgëzuar qeverisjen komunale për punën që po bën në Malishevë dhe për përkushtimin që po tregojnë për të punuar e zhvilluar komunën e

Malishevës.

Kryetari i Degës së Nismës Socialdemokrate në Malishevë, Ragip Begaj, njëherësh edhe kryetar i komunës, ka paralajmëruar aderime të tjera në Malishevë.

Nisma Socialdemokrate është

partia më e madhe në Malishevë që e vetme udhëheq komunën që dy mandate. Në zgjedhjet e fundit në balotazh, të gjitha partitë ishin bërë bashkë, por kandidati i Nismës, Ragip Begaj, kishte fituar me 60 për qind të votave.

MSh-ja do të ofrojë përkujdesje institucionale për të prekurit nga sëmundjet e rralla

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 24 MAJ - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka marrë pjesë të premtën në simpoziumin e parë të Shoqatës për Sëmundje të Rralla në Kosovë. Gjatë këtij simpoziumi ministri Uran Ismaili ka thënë se, duke ditur peshën dhe barrën e madhe financiare që kanë për pacientin dhe familjet e tyre, sëmundjet e rralla meritojnë një trajtim më serioz institucional sesa që ka pasur deri më tani. "Ministria e Shëndetësisë tashmë ka nisur hapat konkretë për zgjidhjen e problemit të tyre përmes mbulimit financiar dhe krijimit të kushteve për trajtim dinjitoz shëndetësor", ka thënë ministri Ismaili.

Më tutje, ministri Ismaili ka treguar se Ministria e Shëndetësisë

më 2018 ka ngritur grupin e punës për hartimin e konceptdokumentit për sëmundjet e rralla, duke synuar gjetjen e rrugës më të mirë dhe më pragmatike, për t'i adresuar nevojat e këtij grupi të ndjeshëm të popullatës. "Pas aprovimit të konceptdokumentit nga qeveria, Ministria e Shëndetësisë do të vazhdojë menjëherë me grupin e punës për hartimin e planit të veprimit për institucionalizimin e përkujdesjes shëndetësore të pacientëve me sëmundje të rralla", ka thënë ministri Ismaili.

Pjesë e këtij plani të veprimit do të jetë plotësim-ndryshimi i Ligjit për shëndetësi, konkretisht përfshirja e dispozitave ligjore për rregullimin e fushës së sëmundjeve të rralla në Kosovë, e që tashmë është afër përfundimit, themelimi i qendrës së veçantë për sëmundjet e rralla



në kudër të shërbimit shëndetësor publik terciar dhe emërimi i një koordinatori nga MSh për sëmundje të rralla për krijimin e komunikimit institucional dhe

bashkëpunimit me qendrat në shtetet e BE-së etj.

Pas kërkesave për financim për medikamentet primare në proceset e rregullta buxhetore vjetore -

për vitin 2019 është siguruar financimi i medikamentit primar (imiglucerase) për sëmundjen Gaucher prej mbi një milion eurosh nga Ministria e Financave.

Çmimi Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Niketë Dardani" iu nda kompozitorit Rexhep Munishi

PRISHTINË, 24 MAJ (ER) - Në një ceremoni të organizuar në kabinetin e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, u bë ndarja e Çmimit Kombëtar për Veprimtari Jetësore "Niketë Dardani" dhe Çmimit Vjetor për Vepër Kamertale për vitin 2018. Çmimi Kombëtar për Veprimtari

Jetësore "Niketë Dardani" iu nda kompozitorit Rexhep Munishit, etnomuzikolog. Shpërblimi financiar për këtë çmim është në vlerë 5 000 euro. Po ashtu, ky çmim u shoqërua edhe me një pllakate.

Çmimi Vjetor për Vepër Kamertale iu nda kompozitorit Ardian

Halimi për veprën "Inside-Out" dhe u shpërblye me 2 500 euro. Ministri Kujtim Gashi ka thënë se ndarja e këtyre çmimeve është një përkujdesje dhe një stimulim që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e bën për komunitetin artistik, e veçanërisht për krijuesit dhe njerëzit e muzikës.



Mbahet akademi përkujtimore për veprimtarin e shquar të Lëvizjes Kombëtare, Abdullah Tahiri

Presidenti: Heroi Abdullah Tahiri ishte emër frymëzues për shumë luftëtarë të lirisë

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se Abdullah Tahiri është figurë tipike dhe rezultat i emancipimit politik dhe kombëtar të atyre gjeneratave që nuk pajtoheshin me politikën e Beogradit dhe të Lidhjes Komuniste të Kosovës. Pas daljes në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Abdullah Tahiri filloi hapat e parë të organizimit të strukturave të saj në Gjiilan



Mulla Idriz Gjilani, Kadri Halimi, Kadri Zeka, Rexhep Mala, Nuh Berisha, në periudha të ndryshme historike, që me jetën dhe sakrificën e tyre e mbajtën të gjallë idealin e çlirimit të Kosovës", është shprehur Thaçi. Presidenti Thaçi ka theksuar se ishte një plejadë e tërë të burgosurish politikë që u shquan në të gjitha dekadat e gjysmës së dytë të

shekullit njëzet si atdhetarë dhe veprimtarë të dalluar. Sipas tij, Abdullah Tahiri kishte përvetësuar këtë frymë politike dhe këtë orientim të drejtë kombëtar që në moshë të re, duke qenë aktiv në organizimin e demonstratave të vitit 1981 edhe si student.

Presidenti ka folur edhe për elementin kundërshtues të Jugosllavisë ku, sipas tij, bëri që të shpërthejnë demonstratat, që u dhanë goditje themeleve të politikës së Beogradit. "Rritja e ndërgjegjes kombëtare e brezit '81, në kontekstin e përgjithshëm politik, ishte edhe një tregues dhe argument më shumë që statusi i autonomisë ishte i pamjaftueshëm për Kosovën. Kërkesa për Republikën e Kosovës ishte shndërruar në ideal gjithëpopullor. Kështu, inteligjenca e krijuar pas hapjes së Universitetit të Prishtinës nuk mund të tjetërsohej nga ideologjia jugosllave e vëlazërim-bashkimit të rrejshëm", ka thënë ai.

Kreu i shtetit ka thënë se Abdullah Tahiri është figurë tipike dhe rezultat i emancipimit politik dhe kombëtar të atyre gjeneratave që

nuk pajtoheshin me politikën e Beogradit dhe të Lidhjes Komuniste të Kosovës, si dhe pas daljes në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Abdullah Tahiri filloi hapat e parë të organizimit të strukturave të saj në Gjiilan.

Presidenti Thaçi ka thënë se duke qenë një veprimtar i njohur, Tahiri burgoset nga policia serbe dhe kështu ndërpritet hovi i një komandanti në ardhje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. "Abdullah Tahiri u bë emër frymëzues për shumë luftëtarë të lirisë anekënd Kosovës. Në sajë të gjakut të dëshmorëve, të sakrificës së martirëve, të rezistencës popullore, të luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të mbështetjes së botës demokratike, në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe intervenimit të NATO-s, Kosova u bë vend i lirë", ka thënë ai.

Duke marrë parasysh kontributin e madh dhe të vazhdueshëm të Abdullah Tahirit, idealet për të cilat u burgos dhe qëndresën e sakrificën e tij, presidenti i vendit, Hashim Thaçi, para dy vjetësh ka nderuar Abdullah Tahirin me nderin "Hero i Kosovës".

**EPOKA
ERE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 24 MAJ - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të premtën ka marrë pjesë në akademinë përkujtimore për heroin Abdullah Tahiri, ku ka thënë se po përkujtohet një veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare që ka rënë në prag të çlirimit të Kosovës 20 vjet më parë. Ai ka theksuar se gjatë tërë kësaj jave në qendër të vëmendjes kanë qenë një nga krimet dhe masakrat më çnjerëzore që ndodhën në Kosovë, masakra e Dubravës. "Shteti i Serbisë me planifikim dhe paramendim kishte tubuar në burgun e Dubravës një numër të madh të të burgosurve dhe robërve të luftës me qëllim të vrasjes dhe asgjësimit të tyre. Abdullah Tahiri dhe 160 të burgosur të tjerë, duarthatë dhe duarlidhur, para 20

vjetëve u vranë mizorisht nga forcat policore serbe vetëm pse ishin shqiptarë që e donin lirinë e vendit të tyre", ka thënë ai.

Presidenti Thaçi ka thënë se pas dy dekadave, asnjë nga urdhërhënësit dhe ekzekutuesit e kësaj masacre nuk dolën para drejtësisë vendore ose ndërkombëtare. Kreu i shtetit ka thënë se këto krime nuk do të harrohen dhe nuk do vjetrohën asnjëherë, ndërsa për burgosjen, dënimin dhe ekzekutimin e bashkëluftëtarit Abdullah Tahiri ai ka thënë se nuk ishte i rastësishëm. "Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, Gjilani me rrethinë, si gjithë Kosova, ishte goditur rëndë në periudhën e administrimit ushtarak, ku doli haptas fytyra e regjimit komunist jugosllav. Kundër regjimit shtypës jugosllav, si ndërgjegje e zgjuar kombëtare, Gjilani dha figura të rëndësishme patriotike dhe nacionaliste. Ishin



Shqyrtohet mundësia që nxënësit të dërgohen dy herë brenda vitit në teatër

PRISHTINË, 24 MAJ (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqri Bytyqi, priti të premtën në takim këshillin iniciator të aktorëve të Kosovës, të kryesuar nga aktori i mirënjohur Enver Petrovci, të cilët paraqitën idenë e nxjerrjes së një Udhëzimi Administrativ i cili do ta bënte obligativ bashkëpunimin e shkollave me teatër, duke i obliguar ato që të paktën dy herë në vit fëmijët nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë t'i dërgojnë në teatër.

Kjo iniciativë ka për qëllim që

përmes të shkuarit në teatër të ndërrohet qasja e fëmijëve në kohën kur është krijuar një lidhje e madhe në mes të fëmijëve dhe pajisjeve teknologjike dhe është rritur numri i dukurive negative në shkollë. Ky aktivitet, po ashtu, do të ndikonte në ngritjen e cilësisë në arsim dhe përballimin e vështirësive në procesin mësimor. Ministri Bytyqi e mirëpriti këtë iniciativë, duke thënë se është shumë e rëndësishme gjetja e mënyrës më të përshtatshme për ta bërë të zbatueshme këtë ide, fillimisht përmes nxjerrjes

së UA dhe më pas përmes një bashkëpunimi të ngushtë me Ministrinë e Kulturës, e cila do t'i krijonte mekanizmat e nevojshëm që fëmijët të dërgohen në teatër apo teatri të dërgohet në zonat, ku një gjë e tillë do të krijonte vështirësi financiare apo logjistike.

Po ashtu, ministri Bytyqi ka thënë se me fillimin e zbatimit të mësimin të rregullt, në kuadër të të cilit janë të parapara edhe aktivitete jashtëkurrikulare, dërgimi i fëmijëve në teatër do të ishte më lehtë i zbatueshëm. Aktori Enver Petrovci nga ana e



tij e falënderoi ministrin për gatishmërinë që kjo ide të rregullohet përmes infrastrukturës

ligjore, e cila do të rregullonte në mënyrë më të detajuar disa çështje.



Lluka: Së shpejti zgjidhja për drejtimin elektroenergjetik të Universitetit të Prishtinës

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 MAJ - Është mbajtur takimi i grupit punues, i cili do ta shqyrtojë mungesën e kuadrove dhe të ardhmen e drejtimit elektroenergjetik në Universitetin e Prishtinës, i cili është formuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozim të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka. Në përbërje nga të gjithë aktorët

relevantë, grupi punues ka shqyrtuar situatën aktuale nëpër të cilën po kalon drejtimi elektroenergjetik në Universitetin e Prishtinës, me këtë rast janë propozuar zgjidhjet dhe masat të cilat duhet të ndërmerren në mënyrë që drejtimi elektroenergjetik pranë Universitetit të Prishtinës të mos rrezikojë mbylljen.

Ministri Lluka para grupit punues ka rikonfirmuar edhe një herë vullnetin politik për të

gjetur një zgjidhje afatgjatë për drejtimin elektroenergjetik, duke theksuar rëndësinë që ka ky drejtim në përgatitjen e kuadrove për të cilët do të ketë nevojë sektori energjetik, si një nga punëdhënësit më të mëdhenj për 20 vjetët e ardhshëm. Lluka, po ashtu, ka njoftuar grupin punues se është duke punuar me institucionet vendore dhe institucione/donatorë ndërkombëtarë për të siguruar bursa për studentet të cilët

studiojnë në këtë drejtim.

Kosova ka kaluar një strategji 10-vjeçare për energji e cila parasheh rreth 3 miliardë euro investime në këtë sektor, ndërsa po përballemi me mungesë të kuadrove. Sektori i energjisë do të jetë punëdhënësi kryesor në 20 vjetët e ardhshëm dhe në asnjë mënyrë nuk duhet ta rrezikojmë mbylljen e Fakultetit të Elektros në Universitetin e Prishtinës.

Pas mbylljes së programit të

doktoratës dhe atij të magjistraturës, po rrezikohet seriozisht edhe programi bachelor, kryesisht për shkak të mungesës së kuadrove të cilët pothuajse të gjithë janë pensionuar.

Grupi punues, në bazë të mandatit, në ditët në vijim do t'i propozojë Qeverisë së Republikës së Kosovës zgjidhjet për drejtimin elektroenergjetik, drejtim ky jetik për zhvillimin e sektorit energjetik në vendin tonë.

Më 28 nëntor përurohet projekti i lumit Mirusha në Gjilan



GJILAN, 24 MAJ (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi dhe kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, kanë nënshkruar një memorandum bashkëpunimi për financimin e projektit për rregullimin e shtratit të lumit Mirusha në Gjilan. Me këtë rast, ministri Matoshi ka treguar se MMPH-ja përmes financimit të këtyre projekteve po i ndihmon komunat në rrugën e tyre të krijimit të një mjedisi të pastër. "Jam i lumtur

që sot përmes nënshkrimit të memorandumit të bashkëpunimit me kryetarin Haziri po financojmë projektin e rregullimit të shtratit të lumit Mirusha në Gjilan, të cilin këtë vit e financojmë në vlerë prej 250 mijë eurosh", ka deklaruar Matoshi.

Ai ka thënë se MMPH-ja këtë vit në Gjilan, së bashku me komunën, investon edhe në rregullimin e parqeve dhe zonave të gjelbëruara rreth Mirushës dhe investimi i tërësishëm në

hapësirat gjelbëruese në Gjilan, sipas këtij projekti, arrin në vlerën e 700 mijë eurove. Matoshi ka treguar se MMPH-ja mbështet dhe financojnë në Gjilan edhe tri projekte të tjera: pastrimin e shtretërve të lumenjve Morava dhe Stanishorka, krijimin e zonave të gjelbëruara në Gjilan dhe ndërtimin e kanalizimit në shtratit e lumit në Doberqan-Gjilan. Po ashtu, ai ka theksuar se Komuna e Gjilanit është fituese edhe e grantit të fushatës "Ta pastrojmë Kosovën".

Në Mitrovicë pritet të realizohet projekti më madhor në sektorin e bujqësisë

MITROVICË, 24 MAJ (ER) - Nën kryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka, së bashku me drejtorin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ekrem Sadiku, kanë pritur në takim përfaqësuesit e kompanisë ndërkombëtare "International Investvent & Business Development Consulting - IDC-KOS", Selim Erden, Mehmet Ulger si dhe Mustafa Cuneyt. Në këtë takim i pranishëm ishte edhe Rustem Abiti nga Oda Ekonomike e Kosovës, i cili e ka njoftuar

nën kryetarin Mujka lidhur me projektin i cili do të realizohet në Komunën e Mitrovicës në sektorin e bujqësisë.

Përfaqësuesit e kompanisë "IDC-KOS" gjatë këtij takimi kanë bërë me dije se në Mitrovicë do të realizohet projekti më madhor në sektorin e bujqësisë, ku do të ngrehet "Parku i Teknologjisë së Agrikulturës", i cili është i vetmi i këtij lloji në vend dhe rajon. Ky projekt do të realizohet në koordinim me disa aktorë që janë njohës të

mirë të kësaj fushe, si Oda Ekonomike e Kosovës, Fakulteti i Bujqësisë i Universitetit të Prishtinës, kompania "IDC-KOS", si dhe Komuna e Mitrovicës.

Pjesë e këtij projekti do të jenë kryesisht gratë dhe fermerët tjerë të cilët merren me bujqësi në Komunën e Mitrovicës, ndërsa që projekti do të përfshijë disa faza, si prodhimin, tharjen, ngrirjen si dhe paketimin ku të gjitha këto prodhime do të eksportohen për në tregun e Bashkimit Evropian.



Haradinaj: Infrastruktura e bën Kosovën më atraktive për sipërmarrësit dhe për investitorët

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

DEÇAN, 24 MAJ - "Autostrada e Dukagjinit është autostradë jo vetëm e shqiptarëve kudo në Ballkan, por është autostradë e Evropës, sepse ajo lidh vendbanime në Evropë", kështu ka thënë të premtën kryeministri Ramush Haradinaj në ceremoninë e fillimit të ndërtimzgjërimit të rrugës regionale R 107 qendrore në Deçan. Me këtë rast, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se kjo zonë ka qenë një tokë e djegur, e shkatërruar dhe minuar, por edhe zonë e lavdisë, me njerëz të aftë të kësaj treve nëpër breza. "Infrastruktura e lehtëson jetën, rrugët e urat lidhin njerëzit, e

bëjnë jetën më të shpejtë, më të saktë, janë nevojë ekonomike, mirëqenie", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se ajo që na bën të ecim përpara, është fakti i kthimit në hartën ekonomike, që do të thotë se infrastruktura na bënë më atraktive për sipërmarrësit, për investitorët, për vende të punës.

Kryeministri Haradinaj ka theksuar se infrastruktura nxjerrë në pah vlerat tona, edhe ato njerëzore e kombëtare, vlerat e lirisë, memorialet dhe gjithë ato vende të shenjta që nderohen, por gjithashtu nxjerrë në dritë edhe resurset tona, mundësitë ekonomike. Duke theksuar rëndësinë e kësaj autostrade, kryeministri Haradinaj ka thënë

se ata që e kritikojnë këtë autostradë janë edhe shkurt-pamës, edhe hileqarë, duke shprehur gjithashtu se i gëzohet autostradës që e lidhë me Gjilanin, me Dheun e Bardhë dhe këtë projekt edhe e ka shtyrë përpara. "Janë qindra mijëra banorë e ekonomi dhe miliona që i kontribuojnë buxhetit të vendit tonë, pa u thirr në tragjeditë e vuajtjet e të kaluarës e kontributin tonë për liri", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se me këto projekte dëshirojnë të lidhen me ekonominë e Kosovës, rajonit dhe globit, të arrijnë më shpejt në Durrës, në Selanik dhe ata që investojnë në vendin tonë, të arrijnë më shpejt me mallin që e prodhojnë këtu, ta dërgojnë në

treje. "Nuk vijnë investimet askund kur nuk ka infrastrukturë, nuk vjen askush të hyjë labirinteve dhe ju siguroj se pa infrastrukturë nuk vijnë investitorët", është shprehur Haradinaj, duke përmendur faktin se, përpos infrastrukturës, duhet të ketë investim në kanalizim, ujëra të zeza dhe rrymë.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se Dukagjini është banka e ujit jo vetëm e Kosovës, por më shumë dhe se i gjithë brezi, prej Grykës së Rugovës e deri në Lepenc, janë mundësi ideale për ujëmbledhës, janë investime shumë të vogla e rëndësia është e jashtëzakonshme. "I besoj vendit tim. E di që s'jemi njerëz të përkryer, e di që gabojmë, e di që duhet të bal-

lafaqohemi me të metat tona, por nuk pranoj të na cilësojë askush të pazotë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se Kosova do t'i bashkohet Evropës, botës euroatlantike.

Ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, ka thënë se kjo ditë është shumë e veçantë për Deçanin pasi po i dhurohet një projekt që ka një simbolikë të veçantë, sepse jo vetëm për qytetarët e Deçanit, por ky projekt po i dhurohet këtij regjioni.

Ndërkaq kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka pohuar se ky projekt është shumë domethënës për qytetin e Deçanit, që ka filluar të hartohet para 15 vjetëve, por që tash i ka ardhur koha e zbatimit falë ndihmës së qeverisë Haradinaj dhe ministrit Pal Lekaj.



Banka Botërore rikonfirmon mbështetjen për bujqësinë në Kosovë

PRISHTINË, 24 MAJ (ER) - Banka Botërore do ta vazhdojë mbështetjen e mëtejme të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë përmes projekteve të ndryshme bujqësore. Kjo bankë do ta vazhdojë mbështetjen e Ministrisë së Bujqësisë edhe në kuadër të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Kështu është thënë të premtën në takim që ministria e MBPZHR-së, Dijana Ziviq, pati me menaxherin e Zyrës së Bankës Botërore në Kosovë,

Marco Mantovanelli dhe specialistin e lartë të bujqësisë, Silvia Mauri. Gjatë këtij takimi është biseduar për programet e ministrisë për mbështetjen e bujqësisë dhe zhvillimit rural në përgjithësi, si dhe për format e bashkëpunimit të mëtejme në fushën e bujqësisë. Ministria Ziviq ka falënderuar menaxherin e BB-së në Kosovë për mbështetjen që kanë dhënë deri më tash për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë dhe theksoi se MBPZHR-ja është e

gatshme të bashkëpunojë me BB-në edhe në të ardhmen për realizimin e shumë projekteve tjera. Ndërsa menaxheri i BB-së, Marco Mantovanelli, ka vlerësuar zhvillimet e deritashme për avancimin e sektorit të bujqësisë në vend dhe ka rikonfirmuar gatishmërinë e Bankës Botërore për mbështetjen e mëtejme të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural në Kosovë përmes projekteve konkrete në kuadër të Strategjisë për Kosovën.



Ish-presidentja Jahjaga viziton Shkollën Fillore "Xhemail Mustafa"

PRISHTINË, 24 MAJ (ER) - Ish-presidentja Atifete Jahjaga ka vizituar Shkollën Fillore "Xhemail Mustafa", ku pati një bashkëbisedim të hapur me nxënësit e kësaj shkolle në lidhje me rolin e grave shqiptare gjatë luftës në Kosovë. "Gjatë bashkëbisedimit me nxënë

vëreja një dëshirë të këtyre të rinjve për ndryshime pozitive në Kosovë dhe një ambicie që sinjalizon që Kosova ka potencial të pakrahasuar me të rinj të tillë. Diskutime të këtij lloji që inkuadrojnë të rinjtë dhe që prekin tema rrënjësore të një shoqërie të shëndoshë e demokratike janë një mënyrë

shumë efikase e zhdukjes së pabarazisë gjinore", ka thënë Jahjaga pas këtij bashkëbisedimi me nxënësit. Ajo i ka inkurajuar të rinjtë e Kosovës që të jenë sa më vokalë dhe të vetëdijësuar për kauza që nuk e prekin vetëm një grup të shoqërisë, por të gjithë qytetarët.



Nisin punimet për asfaltimin e disa rrugëve në fshatrat e Gjakovës

GJAKOVË, 24 MAJ (ER) - Kanë filluar punimet për asfaltimin e rrugëve në fshatin Nivokaz të Gjakovës në gjatësi prej 1 780 metrash. Në këtë projekt do të investohen 117 560 18 euro si dhe do të bëhet asfaltimi i rrugëve në tri lagjet e fshatit Babaj të Bokës në gjatësi totale rreth 1 200 metra, me kosto financiare 61 397 80 euro. Me këtë rast,

kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, është shprehur i lumtur që në tërë territorin e kësaj komune është duke u punuar në infrastrukturë, pavarësisht se janë krijuar vështirësi në qarkullimin rrugor. Ai ka thënë se finalizimi i këtyre projekteve do të sjellë të mira të përgjithshme për banorët e Gjakovës.



Kryeministri bën homazhe në Glllogjan: Misioni i luftëtarëve ka qenë fisnik

GLLLOGJAN, 24 MAJ (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe të premtën në Glllogjan dhe Kodrali të Komunës së Deçanit, me rastin e shënimit të 24 Majit, Ditës së Batalionit Gardist dhe

rënies së dëshmorëve të kombit, të Batalionit Gardist "Shkelzen Haradinaj" të Zonës Operative të Dukagjinit. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj gjatë homazheve në Glllogjan ka thënë se sot është një ditë

vërtetë e veçantë, pasi jo vetëm kujtohen një numër i madh i luftëtarëve të vrarë, por edhe misioni i tyre ka qenë i veçantë, siç ka qenë bartja e të plagosurve, e bashkëluftëtarëve, një mision i vështirë në luftë, por dhe fisnik.

Ndriçohet Anadrinia



PRIZREN, 24 MAJ (ER) - Në kuadër të kontratës kornizë "Instalimi i ndriçimit publik", Drejtoria e Shërbimeve Publike në Prizren është duke vendosur ndriçim publik në aksin rrugor Piranë-Krushë e Vogël. Punimet janë duke u zhvilluar me intensitet të shtuar dhe ndriçimi publik pritet të

hyjë në funksion shumë shpejt. Pas pastrimit të mbeturinave të ngurta, në këtë segment janë mbjellë edhe drunjtë dekorativë në të dyja anët e rrugës. Në kuadër të investimeve të Komunës së Prizrenit, po me këtë intensitet do të vendosen dritat edhe

nëpër shtyllat ekzistuese përgjatë rrugës kryesore në fshatin Randobravë, ku ka qarkullim të madh të nxënësve dhe të qytetarëve. Në kuadër të këtyre punimeve planifikohet të montohen mbi 50 drita efçente me një gjatësi mbi 1 000 metra, të cilat do ta shtojnë sigurinë në këto lokalitete.

Komuna e Shtimes subvencionon gjashtë organizata joqeveritare

SHTIME, 24 MAJ (ER) - Gjatë kësaj jave Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (DSHMS) ka arritur marrëveshjet për subvencionimin e gjashtë organizatave joqeveritare që kanë aplikuar për realizimin e projekteve të tyre. Me këtë rast, drejtori i kësaj drejtorie, Labinot Beqa, ka bërë me dije se pas shpalljes së thirrjes publike për

aplikim kanë konkurruar tetë OJQ, prej të cilave gjashtë janë përfituese të subvencioneve, konkretisht Kryqi i Kuq i Kosovës, Handikos-i, Organizata Komunale e Pensionistëve dhe Invalidëve të Kosovës, Shoqata e të Burgosurve Politikë, Organizata e Veteranëve të Luftës të UÇK-së dhe Oda e Infermierëve të

Kosovës. Beqa ka theksuar se subvencionimi i OJQ-ve dhe shoqatave të lartpërmendura ka për qëllim mbështetjen financiare për realizimin e projekteve për zhvillimin e aktiviteteve avokuese, këshilluese dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare. Të gjitha këto organizata janë nga Komuna e Shtimes.



Meta ofroi shansin për zgjidhjen e krizës politike brenda vendit



Prof. Lisen BASHKURTI

Përfaqësuesit e koalicionit CDU-CSU të qeverisë gjermane të Merkelit hodhën hapin e parë për ndërmjetësim në zgjidhjen e krizës politike shqiptare. Kjo do thotë se kriza politike shqiptare dhe paaftësia dhe papërgjegjshmëria e prodhuesve të saj për ta zgjidhur vetë me mjetet dhe rrugët e duhura po bëhet shqetësim serioz ndërkombëtar. Tanimë edhe për ata që shohin dhe që nuk shohin, edhe për ata që dëgjojnë dhe që nuk dëgjojnë, edhe për ata që duan dhe që nuk duan, edhe për ata të brendshmit dhe ndërkombëtarët po bëhet krejtësisht e qartë se Shqipëria po përjeton një cikël të rrezikshëm krize politike, institucionale, ekonomike, sociale, rajonale dhe integruese. Në të gjitha këto rrafshet krize, spiralja politike është determinuesja. Të gjitha aktorët kryesorë politikë të vendit fajësojnë kundërshtarët për dështimet dhe mburrin vetveten për arritjet. Për dikë mund të jetë gjë e re, për autorin e këtyre rreshtave nuk është aspak e tillë.

Krizat bashkëshoqërojnë çdo sistem dhe çdo shoqëri, duke mos përjashtuar edhe sistemin dhe shoqërinë demokratike. Veçori e sistemit të konsoliduar demokratik është se i konsideron krizat shëndetësim të demokracisë, vetëkorrigjim të saj, lëvizje, ndryshim dhe shans për zhvillim. Dallimi midis demokracive të konsoliduara dhe atyre hibride është se të parat bien në kriza, por kanë aftësinë dhe përgjegjshmërinë për ta gjetur zgjidhjen e duhur me mjete të duhura brenda vendit, të dytat bien në kriza dhe nuk kanë as aftësinë dhe as përgjegjshmërinë për t'i zgjidhur ato vetë pa nevojën e ndërhyrjes të faktorëve të jashtëm.

Në mjedisin e krizës politike shqiptare, tejet të polarizuar dhe të toksikuar, palët kryesore të politikës nuk po e konsiderojnë rëndësinë e madhe që ka zgjidhja e krizës politike brenda vendit me rrugët dhe mjetet e duhura. Me këtë qasje palët politike do të dëshmonin se demokracia shqiptare është në një fazë të re maturimi dhe se ka lënë pas fazën e saj hibride. Përkundrazi, politika shqiptare po dëshmon se hyn në kriza dhe nuk ka aftësinë dhe përgjegjshmërinë për të dalë prej tyre. Në këtë mënyrë demokracia shqiptare

po dëshmon se vazhdon të jetë në fazë hibride.

Në mjedisin politik shqiptar ka një zë që nuk e ka humbur ende arsyen e ftohtë, qetësinë, vetëpërmbytjen, neutralitetin dhe konstitucionalitetin - ky zë është presidenti i Republikës, Ilir Meta. Presidenti Meta është i vetmi që ka dëshmuar dhe po dëshmon qasjen e duhur për gjetjen e zgjidhjes së krizës politike brenda vendit, me rrugët dhe mjetet e duhura. Presidenti Meta është i vetmi që po heshtë kur të tjerë po llapin natë e ditë me retorika politikisht boshe dhe po flet kur të tjerët me përgjegjësitë kryesore të krizës po heshtin. Mbi të gjitha, presidenti Meta, ndryshe nga aktorët e tjerë politikë, qasjen aktive dhe kritike e bashkëshoqëron me propozime konkrete për zgjidhje.

Në deklaratat e ditëve të fundit presidenti Meta është fokusuar publikisht në krizën politike që ka kapluar vendin. Qysh në krye të herës, presidenti Meta ka qenë qortues për të dyja palët, mazhorancën dhe opozitën. Ai e ka qortuar dhe njëherazi këshilluar me kohë dhe vazhdimisht mazhorancën, qeverinë dhe kryeministrin, që të shohin realitetet në sy, t'i ulin tonet e arrogancës e të kokëfortësisë, të kërkojnë e gjejnë rrugën e dialogut, ta përmirësojnë informimin e komunikimin me opinionin publik, politik e mediatic, të jenë transparentë në vendimet dhe veprimet e tyre, të jenë luajalë me kushtetutën dhe ligjin dhe seriozë me detyrimet në procesin e integritetit në BE.

Nga ana tjetër, presidenti Meta qysh në krye të herës ka qenë qortues e këshillues edhe për opozitën. Meta ka kritikuar seriozisht dhe publikisht opozitën për qasjen ekstreme të dorëzimit të mandateve dhe largimin nga parlamenti si dhe për të qenë të përmbajtur në qëndrimet dhe aksionet e saj politike e qytetare. Meta i ka sugjeruar në mënyrë insistuese opozitës që të ndërtojë një aksion dydimensional, parlamentar dhe qytetar, si dhe ta menaxhojë lëvizjen politike dhe aksionin qytetar me vetëpërmbytje e pa dhunë.

Në mënyrë të veçantë, presidenti Meta mjeshhtërisht i është shmangur rënies në 'pasionet e politikës shqiptare' të ditës si dhe në tymnajat e sulmeve të mirëpaguara dhe egoistike. Si një kundërshtar i vendosur i polarizimit politik dhe i konfliktualitetit mazhorancë-opozitë, presidenti Meta ka dhënë sinjale të herëpashershme të gatishmërisë së tij për ta marrë përsipër barrën e rëndë të ndërmjetësimit midis palëve, përmes krijimit të një tryeze politike të të gjithë

faktorëve legjitimë të spektrit politik përfaqësues të vendit.

Mjerisht, çdo sinjal i presidentit për t'u vënë në shërbim të lehtësimit të gjetjes së rrugëve për zgjidhjen e krizës brenda vendit është pritur me retorikë mospajtuese, agresive dhe cinike nga mazhoranca, qeveria dhe vetë kryeministri. Nga ana tjetër, edhe opozita, pavarësisht disa partive të vogla të grupit opozitar, nuk ka shfaqur vullnet të qartë për ndërmjetësimin e presidentit Meta, madje në heshtje ka dhënë shenja mospajtuese.

Në daljen e kohëve të fundit presidenti rikonfirmoi sërish vullnetin e tij të plotë për të ndërmjetësuar për zgjidhjen e krizës politike. Por, Meta, më shumë duke iu drejtuar zërave që ia kanë kërkuar atij këtë rol, u deklarua se nuk mund të ndërmjetësojë kur dy palët kryesore nuk e mbështesin dhe nuk kanë vullnet për një gjë të tillë.

Palët kondicionojnë me njëra-tjetrën në mënyra tërësisht përjashtimore. Njëra palë, opozita, ka vënë kushte për dialog dorëheqjen e kryeministrit, qeverinë tranzitive, shtyrjen e zgjedhjeve lokale e më tej

ndryshimin e sistemit, kodit zgjedhor dhe përshejtimin e zgjedhjeve të përgjithshme. Ndërsa pala tjetër, mazhoranca, përjashton dorëheqjen e kryeministrit, insiston në mbajtjen e zgjedhjeve më 30 qershor edhe pa opozitën si dhe mbajtjen e zgjedhjeve të ardhshme në afatin kushtetues më 2021.

Në këtë pozicionim pa asnjë hapësirë manovrimi midis palëve, vënia e presidentit në dispozicion të palëve për ndërmjetësim negociues është njëherazi edhe sakrificë dhe kontribut dinjitoz. Polarizimi ekstrem mazhorancë-opozitë dhe konflikti që ky polarizim prodhon është përgjegjësi e madhe historike e faktorëve politikë. Ky polarizim ka shkaktuar dhe do të vijojë të shkaktojë pasoja të drejtpërdrejta në jetën politike, institucionale, ekonomike dhe sociale, do ta dëmtojë rëndë imazhin e Shqipërisë në Evropë dhe do ta ngadalësojë procesin e integritetit të vendit në BE.

Duke mos pranuar ndërmjetësimin e presidentit Meta për zgjidhjen e krizës politike brenda vendit, dy palët kryesore të politikës, sidomos mazhoranca, qeveria dhe kryeministri i vendit,

po humbin një shans të madh historik - atë të demonstrimit të shkallës së pjekurisë të politikës shqiptare për t'u përballur me kriza dhe për t'i zgjidhur ato me mjete politike brenda vendit. Dy palët e politikës, por sidomos mazhoranca, qeveria dhe kryeministri, po e shpien procesin në 'dorëzimin' e zgjidhjes së krizës te faktorët ndërkombëtarë. Ky është dështim i plotë i tyre.

Është ky moment që shtyu koalicionin CDU-CSU të Gjermanisë që ta ndërmarrë iniciativën për ndërmjetësim për zgjidhjen e krizës në Shqipëri. Personalisht, nuk jam kundër ndërmjetësimit të CDU-CSU për zgjidhjen e krizës por, pa dyshim, do të kisha dashur që, më në fund, pas 28 vjetëve tranzicion, ta dëshmonim aftësinë dhe përgjegjshmërinë për t'i adresuar krizat e brendshme me anë të dialogut dhe përmes institucioneve politike dhe institucionale të brendshme. Presidenti Meta e ofroi këtë mundësi të fundit për ta bërë këtë. Arroganca dhe kokëfortësia, paaftësia dhe mungesa e përgjegjshmërisë së politikës e humbën këtë shans. Politika shqiptare po provon se nuk po del dot nga faza hibride e saj.



Ndahen 562 mijë euro për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Gjilan

GJILAN, 24 MAJ (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka bërë me dije se janë ndarë edhe 562 mijë euro të tjera për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare në Gjilan. Ai së bashku

me kryetarin e Gjilanit, Lutfi Haziri, kanë nënshkruar të premtën plotësim ndryshimin e marrëveshjes së mirëkuptimit për këtë projekt, të cilin Ministria e Shëndetësisë e financon me

një milion euro. "Qendra e re e Mjekësisë Familjare do t'i plotësojë të gjitha kushtet për shërbime shëndetësore të dinjitetshme për qytetarët e Gjilanit", ka thënë Ismaili.

Zgjedhjet evropiane provë e rëndësishme për Macron

PARIS, 24 MAJ - Dy vjet pas zgjedhjes së tij, kemi tashmë një Emmanuel Macron që nuk pëlqehet në Francë, që përdoret prej gjashtë muajsh krize nga jelekverdhet dhe që luan të dielën me evropianët për titullin e vetëshpallur kampion, të demokracisë liberale kundër populistëve.

Duke e vendosur veten në vijën e frontit në fushatë, presidenti francez mori një rrezik tjetër, një pengesë kundër së djathtës ekstreme që mund ta detyrojë atë të riorganizojë ekipin e tij

qeveritar dhe të rishikojë ritmin e reformave të tij.

Sondazhet, të cilat për një kohë të gjatë kanë vënë "Frontin Kombëtar" të Marine Le Pen dhe partinë presidenciale "La République en Marche" kokë më kokë, vendosin tashmë listën e ekstremit të djathtë në krye, me nga 0,5 në 2 pikë, në fund të një fushate që mori pamjen e një dueli mes dy kampeve.

Presidenti francez gjithashtu tha se BE-ja nën këtë presion populist është nën kërcënimin e një "rreziku ekzistencial" dhe

"rrezikun e zhvendosjes".

Ai shpreson të ndërtojë një koalicion të madh progresistësh përballë atyre që duan të shkatërojnë Evropën nga nacionalizmi.

Nga ana tjetër, në një intervistë për gazetën "Le Parisien", një nga strategët kryesorë të kampit populist, amerikanin Steve Bannon, gjithashtu vlerëson, se zgjedhjet në Francë do të jenë "më të rëndësishmet" e evropianëve.

"Është një referendum për Macron dhe vizionin e tij për Evropën", thotë Bannon.



Largimi i përbotshëm i kryeministres britanike Theresa May

Kryeministrja britanike Theresa May u përbot në përfundim të paraqitjes së saj kur shpalli se u pajtua me thirrjet e Partisë Konservatore për t'i hapur rrugë një udhëheqësi të ri që do të provojë të tejkalojë bllokadën e krijuar rreth procesit të largimit të Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Evropian

LONDËR, 24 MAJ - Kryeministrja britanike, Theresa May, shpalli të premten se do të largohet nga posti i kryeministres së Mbretërisë së Bashkuara dhe nga udhëheqja e konservatorëve më 7 qershor.

Kryeministrja britanike u përbot në përfundim të paraqitjes së saj me të cilën shpalli se u pajtua me thirrjet e Partisë Konservatore për t'i hapur rrugë një udhëheqësi të ri që do të provojë të tejkalojë bllokadën e krijuar rreth procesit të largimit të Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Evropian.

"Tani është e qartë për mua se është në interesin më të mirë të vendit që një kryeministër të ri të udhëheqë këtë përpjekje. Kështu që sot po e shpall se do të jap dorëheqjen si udhëheqëse e Partisë Konservatore të premten më 7 qershor", tha May.

Ajo shprehu keqardhjen që Parlamenti britanik hodhi poshtë tri herë me radhë marrëveshjen e negociuar prej saj

për largimin nga Bashkimi Evropian.

Afati fillestar ishte më 29 mars, por dështimi i votimit të marrëveshjes bëri që kryeministrja May të negociojë një afat të ri me Bashkimin Evropian i cili u pajtua të shtyjë afatin e Brexit-it deri më 31 tetor.

May do të vazhdojë punën si kryeministër në detyrë deri në zgjedhjen e udhëheqësit të ri, një proces që mund të marrë disa javë.

Udhëheqësi i ri i Partisë Konservatore do të bëhet kryeministër dhe vendi nuk ka nevojë të shkojë në zgjedhje të reja.

Kandidati më i përfolur si pasues i saj është Boris Johnson, ish-ministri i Jashtëm, që ishte një nga mbështetësit kryesorë të referendumit për Brexit-in në qershor të vitit 2016.

Johnson, duke e falënderuar May për shërbimin ndaj vendit dhe Partisë Konservatore, tha se "është koha që të përmbushen thirrjet e saj: të bashkohemi dhe



ta zbatojmë Brexit-in".

Kryeministrja skoceze, Nicola Sturgeon tha se largimi i May, nuk do ta zgjidhë rrëmujën e Brexit-it që e kanë krijuar konservatorët. Vetëm duke e kthyer çështjen te qytetarët mund të

ndodhë kjo. Duke pasur parasysh rrethanat aktuale, gjithashtu duket thellësisht e gabuar që një tjetër konservator të marrë drejtimin e qeverisë pa zgjedhje të përgjithshme.

Shefi i Partisë Laburiste në opozitë,

Jeremy Corbyn, tha se largimi dëshmon se May "pranoi atë që e dinte gjithë vendi për shumë muaj: ajo nuk mund të qeverisë, sikurse as partia e saj e ndarë". Ai bëri thirrje që vendi të shkojë në zgjedhje të reja.

Trump i jep përgjegjësi të reja Prokurorit të Përgjithshëm

UASHINGTON, 24 MAJ - Presidenti amerikan, Donald Trump ka urdhëruar agjencitë amerikane të Inteligjencës që të bashkëpunojnë me zyrtarët e Departamentit të Drejtësisë, rreth të gjeturave të këshilltarit special, Robert Mueller, gjatë hetimeve që ka zhvilluar për ndërhyrjen ruse në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016 në Shtetet e Bashkuara.

Kësaj here, Prokurori i Përgjithshëm, William Barr do të hetojë nëse fushata e presidentit Trump është spiunuar gjatë

fushatës zgjedhore.

Vendimi i Trumpit shënon hapin tjetër që ka bërë Shtëpia e Bardhë me qëllim të zbehjes së përfundimeve që kanë dalë nga raporti i Muellerit.

Bazuar në të gjeturat e publikuara nga ky raport, agjencitë amerikane të Inteligjencës kanë pasur të drejtë kur kanë deklaruar se Rusia ka ndërhyrë në zgjedhjet e ShBA-së, mirëpo nuk janë gjetur prova të mjaftueshme për të vërtetuar se ekipi i presidentit ka penguar drejtësinë.

Prej publikimit të raportit, Trumpi dhe disa aleatë republikanë kanë bërë thirrje për t'i hetuar, hetuesit e përfshirë në hetime.

Ky hetim është hapur fillimisht nga FBI-ja, mirëpo më pas në të është angazhuar Mueller, meqë Trumpi pati shkarkuar James Comey nga pozita e udhëheqësit të FBI-së.

Shefi i Departamentit amerikan të Drejtësisë, prokurori, William Barr, ka supozuar se FBI-ja ka "spiunuar" fushatën e Trumpit, ndonëse një pretendim i tillë është hedhur poshtë nga drejtori aktual i FBI-së.





BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



E jashtëzakonshme

I gjithë fshati u kthye në azil pleqsh

Shpopullimi e ka detyruar bashkinë e një qyteze në Spanjë që të marrë masa disi të pazakonta. "Kur një i moshuar futet në azil, sikur i fshihen të gjitha kujtimet dhe sikur i mbyllet dera për të shtëpia e tij. Këtu, i moshuari ka shtëpinë e vet, dhe qyteza është përshtatur me nevojat e të moshuarve", ka thënë kryetari i bashkisë në qytezën Pesceza të Spanjës. Shkolla e fundit në qytezë kishte 25 vjet që ishte mbyllur. Sot më



shumë se 65 për qind e popullsisë janë mbi 60 vjeç dhe qyteza është përshtatur për pleqtë.

FOTO E DITES




Në Frankfurt të Gjermanisë dielli shihet midis linjave të energjisë. /AP/

E rrallë

Studentët krijojnë një qen robot

Disa studentë në Kaliforni kanë krijuar një qen robot, i cili ka katër këmbë dhe mund të rrokulliset e të ngrihet në ajër. Qeni robot është në gjendje t'i ngrehë tri nga këmbët e tij në ajër deri në gjysmë metër lartësi. Ky prodhim ka kushtuar rreth 3 000 dollarë dhe është krijuar me qëllimin që të riprodhohet përsëri në të ardhmen. Pas disa vjetëve këta robotë mund të



kushtojnë qindra e mijëra dollarë pasi do të jenë edhe më të mbrojtur.

BARSOLETA E DITËS



Shkon njëri lakuriq në kafene. Kamerieri, pasi merr porosinë, nuk ia ndan sytë. Ky e vëren këtë dhe pak me nervozë i thotë:
- Çka m'i ke hapur sytë ashtu?
- Veç jam kah të këqyri ku i ke paratë për pagesë, ia kthen kamerieri.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00

"AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



16.05.2019

"THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe **boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

 <p>DASHI Mirë që miqtë janë gjithmonë pranë jush për t'ju qartësuar idetë sepse do ta gjeni veten në një rrëmujë të çuditshme mendimesh.</p>	 <p>DEMI Mes miqve tuaj dhe partnerit ka shumë dallime mendimesh dhe idesh. Do të jeni i pranishëm në një debat që nuk do të keni mundësi ta evitoni.</p>	 <p>BINJAKËT Shumë ditë e qetë sot. Përveç punës, nuk keni asgjë tjetër interesante që mund t'jua zë ditën. Nuk do të jeni në humor përgjatë paradites.</p>	 <p>GAFORRJA Duhet të tregoheni më elastikë me persona të cilët në një mënyrë apo në një tjetër ndikojnë në të ardhmen tuaj. Ndonjëherë bëni mirë të heshtni.</p>	 <p>LUANI Gjithçka që po bëni për momentin ju intrigon dhe ju jep shumë kënaqësi. Si në karrierë, si në çështjet personale, gjërat po shkojnë më mirë nga sa prisnit.</p>	 <p>VI R G J E R E S H A Dukeni të përhumbur sot, por do të dalë një person që do t'ju tregojë rrugën e duhur. Keni filluar ta kuptoni rëndësinë e gjërave të vogla.</p>
 <p>PESHORJA Planetët nuk i keni në anën tuaj sot dhe duhet ta zgjidhni vetë çdo problem që mund të hasni. Ndihehi si të zënë në kurth lidhur me një situatë.</p>	 <p>AKREPI Paraqiten plane për udhëtime të largëta për ju dhe sot është dita kur do të vendosni njëherë e mirë se çfarë do të bëni.</p>	 <p>SHIGJETARI Sot nuk jeni në humor të mirë dhe do ta reflektoni dhe mbi vendime që do të peshojnë shumë në të ardhurat tuaja.</p>	 <p>BRICJAPI Shenja nervozizmi që nuk po arrini t'i kontrolloni do të shfaqen gjatë një takimi të rëndësishëm si pasojë e një neglizhence të një personi të afërt.</p>	 <p>UJORI Kjo ditë, përveç reduktimit të dukshëm të financave, do të ketë edhe probleme të tjera dhe në fund të saj do të jeni shumë të tensionuar.</p>	 <p>PESHQIT Edhe pse jeni fiksuar pas një argumenti të caktuar sot, dikush do t'jua heqë mendjen me të dhënat që do t'ju japë për një temë komplet tjetër.</p>

Jane Fonda pendohet për ndërhyrjet plastike që i ka bërë



Në moshën 81-vjeçare, ylli i Holliwoodit, Jane Fonda, është pa dyshim një nga gratë më të bukura në botë. Por, ajo ka bërë disa ndërhyrje. "Më vjen mirë që dukem bukur për moshën time, por kam bërë operacione plastike",

ka thënë ajo. Kirurgjia e saj konsistoi me ndërhyrje rreth syve dhe mjekrës, në mënyrë që të mos ketë shumë rrudha. Por në moshën e saj ajo dëshiron të kishte më shumë të tilla dhe përfundimisht pendohet për ndërhyrjet që i ka bërë në rini.

'Spiderman'-i bëhet biond



Aktori i cili e luajti rolin e Spidermanit, Andrew Garfield, ka ndryshuar pamjen. Garfield ka ngjyrosur flokët dhe është bërë biond. Sipas "Daily Mail", Garfield

dukej shumë bukur teksa shëtitej rrugëve të Los Anxhelosit. Adrew ka qenë në lidhje dashurie me aktoren e famshme Emma Stone, por janë ndarë pas një kohe.



Rita Ora pas shfaqjes në Mbretërinë e Bashkuar: Faleminderit që jeni fansat më të mirë!

Këngëtarja Rita Ora ka nisur turnetë në Mbretërinë e Bashkuar. Përmes tyre Rita Ora do ta promovojë albumin Phoenix. Pas shfaqjes së parë këngë-

tarja ka shkruar për emocionet e saj. "Faleminderit që jeni turma më e mirë për t'i nisur shfaqjet e mia. Unë mund ta ndiej energjinë tuaj", ka shkruar Rita në rrjete sociale.

Kevin Hart qan pasi lexon skenarin e filmit 'Fatherhood'



Aktori i njohur Kevin Hart do të luajë në filmin e ri "Fatherhood". Këtë lajm e ka bërë me dije vetë aktori me anë të një shkrimi në rrjetin social "Instagram". Ai ka thënë se ka qarë pasi ka lexuar 35 faqet e para të skenarit të këtij

filmi. "Jam shumë i lumtur. Unë do t'i filloj xhirimet e filmit tim të ardhshëm në qershor. Është një film i zhanrit dramë 'Fatherhood'. "Skripti i skenarit është shumë i mirë. Unë kam filluar të qaj pasi kam lexuar 35 faqet e para", ka thënë Hart.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

Besa synon titullin e gjashtë radhazi

Skuadra e Besës po synon titullin e gjashtë në elitën e hendbollit të Kosovës, kurse Kastrioti, pas Kupës, po beson se mund ta ndalë hovin e pejanëve edhe në kampionat. Ndashja e dytë mes këtyre dy skuadrave zhvillohet sot (e shtunë) në Palestrën "Bill Clinton" nga ora 18:00



Ramadani. Ndashja fillon në orën 18:00 dhe zhvillohet në Palestrën "Bill Clinton".

Titulli mund të vendoset edhe në konkurrencën e femrave

Ashtu sikurse në Superligën e meshkujve, sot (e shtunë) titulli i kampiones mund të vendoset edhe në Superligën e femrave. Istogu ndeshjen e parë e fitoi me rezultat bindës ndaj Vushtrrisë (32-23), kurse sot do t'i mjaftojë edhe barazimi që të shpallet kampione për herë të parë në histori të klubit. Në anën tjetër, ndeshjen synon ta fitojë edhe skuadra e Vushtrrisë, e cila është në kërkim të rikthimit të trofeut në rangun elitër të hendbollit në Kosovë. Kjo ndeshje zhvillohet në Vushtrri nga ora 17:00.

përkundër paraqitjes së mirë në Palestrën "Karagaçi", në fund është dashur të pajtohet me humbje. Kapiteni i Kastriotit, Rron Ramadani, ka ftuar tifozët që ta përkrahin skuadrën e zemrës dhe në këtë mënyrë t'i ruajnë me fitore shpresat për t'u shpallur kampionë. "Ne humbëm

betejën, por jo luftën. Jemi në garë për titull, ndërsa sa i përket ndeshjes së dytë që luhet në Ferizaj, jemi të përgatitur dhe të motivuar për fitore. Ftoj të gjithë hendbolldashësit, tifozët, që të shtunën të jenë në numër sa më të madh në përkrahje të klubit të tyre të zemrës", ka thënë

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 24 MAJ - KH Besa Famgas po synon që sot (e shtunë) në Palestrën "Bill Clintoni" ta mposhtë Kastriotin për herë të dytë dhe të shpallet kampion i Kosovës për herë të gjashtë radhazi. Për ta siguruar titullin skuadrës pejana i mjafton edhe barazimi, pasi ndeshjen e parë e fitoi në Pejë me rezultat 16-115. Hendbollisti i Besës, Bajram Idrizi, ka thënë se në ndeshjen që

zhvillohet në Ferizaj Besa do të hyjë sikurse rezultati i përballjeve të jetë 0-0. "Tani presim ta sigurojmë titullin në ndeshjen e dytë në Ferizaj. Jemi të mobilizuar maksimalisht dhe do të udhëtojmë të shfaqim lojë të mirë dhe të shënojmë fitore. Me fitore e sigurojmë titullin e gjashtë me radhë. Do të paraqitemi në ndeshjen e dytë sikurse rezultati të jetë në fillim të serisë, pra 0-0. Me angazhim maksimal synojmë fitore të re dhe titull të ri", ka thënë Idrizi. Ndërsa skuadra e Kastriotit, edhe



'Epoka e re' siguron titullin në Media Ligë

Ekipi i gazetës "Epoka e re" e ka siguruar titullin e kampionit në Media Ligë, dy xhiro pa përfunduar kampionati. Në ndeshjen e zhvilluar të premtën në fushën "Arena", ekipi i "Epokës së re" e ka mposhtur ekipin e "Gazeta Metro"-s me rezultat 5-3 dhe ka grumbulluar 70 pikë.

"Epoka e re", që ishte kampione e Media Ligës edhe në vitin 2010, në këtë edicion ka shkëlqyer me paraqitje dhe ka regjistruar 22 fitore, 4 barazime dhe 2 humbje. Në dy ndeshjet e mbetura "Epoka e re" do të luajë ndaj "D+" dhe "Telegrafi"-t.

SHKURT

Drita synon këta tre futbollistë

Ish-kampionia e Kosovës në futboll, Drita nga Gjilani, po synon të përforcohet për edicionin e ri të futbollit 2019/2020. Skuadra nga Gjilani është duke tentuar transferimin e kapitenit të Llapit, Hamdi Namani dhe mbrojtësit Ilir Blakçori. Synim tjetër i Dritës është edhe Bujar Idrizi, i cili ka qenë pjesë e skuadrës së Kukësit. Kampionatin e fundit skuadra e Dritës e mbylli në pozitën e katërt me 48 pikë.

Federata e Badmintonit pranohet në WBF

Federata e Badmintonit të Kosovës (FBK) e ka kryer me sukses procesin e ndërkombëtarizimit. Pas vetëm disa muajsh themelimi, kjo federatë u pranua me të drejta të plota në Federatën Botërore të Badmintonit (WBF). FBK-ja u bë anëtarja e 192-të e WBF-së. Vendimi u mor në Asambleshën e Përgjithshme të Federatës Botërore të Badmintonit, të mbajtur në Nanjing të Kinës.

Kosova me katër shenjëtarë përfaqësohet në Kupën Botërore

Përfaqësuesja e Kosovës në Shenjëtari Sportive do të marrë pjesë në Kupën Botërore që mbahet në Munchen nga 24-31 maj 2019. Kosova do të garojë me katër sportistë në disiplinën pushkë dhe pistoletë. Kjo garë mbahet nën organizimin e Federatës Ndërkombëtare të Shenjëtarisë Sportive - ISSF, kurse Kosovën do ta përfaqësojnë në disiplinën pushkë 10 metra: Urata Rama Gatica dhe Drilon Ibrahim, kurse në disiplinën pistoletë 10 metra: Lumturie Rama dhe Nexhat Sahiti. Federata e Shenjëtarisë pret sukses nga kjo garë ndërkombëtare ku edhe pritet të arrihet norma minimale olimpike, që mundëson marrjen e pikëve për kualifikim dhe pjesëmarrje në Lojërat Olimpikë që mbahen në "Tokyo 2020".

Josa: Kemi bërë një kampionat shumë të mirë

PRISHTINË, 24 MAJ - Trajneri i Prishtinës, Mirel Josa, ka folur për herë të parë pas humbjes në sfidën vendimtare të titullit ndaj Feronikelit (1-0). Tekniku më i trofeshëm në Shqipëri ka thënë se është i kënaqur me sezonin pavarësisht se nuk arri-

ti asnjë trofe. Ai e ka uruar Feronikelin për titullin e fituar. "Jam i kënaqur me ekipin, me sezonin, me djemtë me të gjithë. Më vjen keq që nuk ia dolëm dot ta fitonim titullin dhe t'i kënaqnim tifozët. Dua të them që skuadra tregoi lojë të

mirë, e mbajti stresin, ishte e përpiktë, por në fund nuk ia doli edhe pse luftoi në çdo sekondë. Nga ana tjetër, dua ta uroj Feronikelin për titullin. E meritoi që të dilte kampion, sepse fitoi në fushë", ka thënë Josa për "Panorama Sport".

"Unë, nga ana tjetër, jam krenar për lojtarët e mi, të cilët bënë gjithçka të dilnin kampione edhe këtë vit. Ndonjëherë fati nuk është me ty apo me skuadrën, por unë them se kemi bërë një kampionat shumë të mirë", ka shtuar Josa.



Ramosi mund të largohet nga Real, Ronaldo e dëshiron në Juventus

Madrid, 24 maj - Real Madridi mund ta humbasë kapitenin Sergio Ramos, i cili ishte kyç në sukseset e klubit në vitet e fundit. Sipas raportimeve të mediave iberike, Ramosi është

në dyshim për të ardhmen. Kapiteni i Realit mbylli sezonin e 14-t në Madrid. Ai kurrë nuk ka marrë parasysh ofertat që i kanë ardhur, ndër- sa situata ka ndryshuar.

Ramos po tundohet nga ideja për të provuar emocione të tjera në karrierën e tij. Nëse ndahet me Realin, katër klube janë gati t'i plotësojnë çdo dëshirë: PSG-ja, Manchester

United, Juventus dhe Liverpooli. Cristiano Ronaldo u ka kërkuar drejtuesve të Joves që të veprojnë shpejt dhe t'i nisin negociatat me 33-vjeçarin.



25 komuna me mbi 10 mijë fëmijë të pavarësisë festojnë Ditën Olimpikë

PRISHTINË, 24 MAJ - Drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës, presidenti Besim Hasani, sekretari i përgjithshëm, Shasivar Haxhijaj dhe nënpresidenti Gazmend Maxhuni, kanë zbuluar detajet e organizimit të edicionit të tetë të Ditës Olimpikë 2019, që organizohet më 27 maj 2019. Dita Olimpikë organizohet këtë herë në 25 komuna, ndërsa pjesëmarrës janë fëmijët e lindur në vitin e pavarësisë së Kosovës (2008). KOK-u do ta organizojë Ditën Olimpikë më 27 maj, pasi pikërisht në këtë datë, 27 vjet më parë, u themelua Komiteti Olimpik të Kosovës. "Për dallim prej viteve të tjera, ku gjashtë edicione janë zhvilluar vetëm në Prishtinë, ndërsa vitin e kaluar në shtatë regjione, këtë herë Dita Olimpikë 2019 do të organizohet në 25 qytete. Bëhet fjalë për më tepër se 10 mijë fëmijë, të cilët do të vrapojnë në të njëjtën kohë. Pra përpjekjet tona, falë edhe ndihmës së komunave, janë që në orën 9:30 të gjithë fëmijët e lindur në vitin e pavarësisë së Kosovës të vrapojnë dhe ta japin mesazhin për t'u marrë me sport, që është edhe qëllimi i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar", ka thënë Hasani, i cili ka shtuar se qëllimi i KOK-ut është që këta fëmijë të vrapojnë gjatë tërë jetës së tyre, derisa ftoi të gjithë prindërit, gjyshërit dhe qytetarët e tjerë të jenë të pranishëm në sheshet e komunave të tyre.



Komunat në të cilat do të organizohet Dita Olimpikë 2019 janë: Prishtina, Gjilani, Ferizaj, Mitrovica, Gjakova, Vushtrria, Podujeva, Skënderaj, Suhareka, Drenasi, Vushtrria, Dragashi, Obiliqi, Kaçaniku, Deçani, Malisheva, Fushë Kosova, Rahoveci, Shtimja, Klina, Vitia, Istogu, Kamenica, Juniku dhe Hani i Eleziti. Prizreni dhe Peja, janë dy prej komunave të mëdha dhe të vetme që nuk i bashkuan këtij projekti. Sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Shasivar Haxhijaj, foli për të ftuarit që do të jenë në ceremoninë hapëse nëpër komuna dhe të cilët do ta bëjnë edhe më madhështore këtë ditë. "Për ta bërë edhe më të rëndësishme këtë ditë, kemi ftuar gjithë

liderët shtetërorë të jenë pjesëmarrës në komuna të ndryshme për ta bërë hapjen. Deri më tash ministri i Sportit, Kujtim Gashi, e ka konfirmuar ftesën, pastaj kampionia olimpikë Majlinda Kelmendi dhe trajneri i saj, Driton Kuka, ish-presidentja Atifete Jahjaga, Mehmet Bogujevci, ish-boksier i mirënjohur. Jemi në pritje të konfirmimit edhe nga kryeministri, presidenti dhe kryeparlamentari. I ftuar është edhe ylli i futbollit tonë, Milot Rashica", deklaroi Haxhijaj. Kryetari i Komisionit për organizimin e kësaj dite, Gazmend Maxhuni, ftoi të gjithë të jenë të pranishëm, në mënyrë që t'i shtyjmë fëmijët të merren me sport.

SHKURT

Mourinho: Nëse Kloppi nuk e fiton finalen do të ishte e rëndë

Jurgen Klopp e ka humbur një finale të Ligës së Kampionëve sa ishte trajner i Borussia Dortmundit dhe një tjetër e humbi vitin e kaluar me Liverpoolin. Trajneri gjerman sërish është në finale me Liverpoolin që më një 1 qershor përballen me Tottenham Hotspurin. Jose Mourinho, duke komentuar këtë finale, ka thënë se nëse Kloppi e humb edhe këtë finale, do të ishte e rëndë. "Nëse Kloppi fiton, do të ishte një arritje e madhe për të. Ndryshon puna nëse nuk ia del. Të humbësh finalen e tretë të Ligës së Kampionëve do të ishte shumë, shumë e rëndë. Ai është një djalë shumë pozitiv për momentin dhe mendon vetëm për ta fituar trofeun", ka thënë ish-trajneri i Manchester Unitedit, Real Madridit, Chelseat dhe Interit.

Chiellini: Kisha ofertë nga Real, por e refuzova

Giorgio Chiellini është pjesë e Juventusit që prej vitit 2005. Mbrojtësi ka dhënë gjithçka për "bardhezinjtë", është shtylla e repartit defensiv dhe sot mban shiritin e kapitenit. Një mbrojtës klasik nga ata që e kanë të shenjtë ruajtjen e portës me çdo lloj mënyre. Kundërshtarët e urrejnë, ndërsa tifozët e tij e adhurojnë. 34-vjeçari është i lidhur shumë me Juventusin, por në një moment ishte gati t'i braktiste. Mori një ofertë të mirë, më saktë të përfuzueshme, por ai ia doli ta refuzojë. Real i Madridit kërkoi shërbimet e mbrojtësit në verën e vitit 2010 dhe Chiellini u tundua. "Në vitin 2010 isha shumë pranë kalimit te Real i Madridit, por në fund vendosa të qëndroja te Juventus. Më frenoi pakënaqësia e madhe që do të krijohet pas largimit tim", ka thënë Chiellini.

Dortmundi kërkon Mandzukiqin

Borussia Dortmund po kërkon sulmuesin e Juventusit, Mario Mandzukiq, për sezonin e ardhshëm. Sipas "Bild", shefat e Dortmundit, Matthias Sammer, Michael Zorc dhe Hans-Joachim Watzke, janë të gjithë të interesuar për përvojën e Mandzukiqit, edhe pse trajneri Lucien Favre ende nuk duket se është bindur. Kroati ka luajtur vetëm 33 ndeshje në sezonin 2018-2019, duke shënuar 10 gola dhe duke asistuar shtatë herë. Para se ta vishite fanellën e Juventusit, Mandzukiq ka qenë pjesë e futbollit gjerman, duke luajtur te Wolfsburgu dhe Bayern Munichu.

Unitedi, ofertë të 'çmendur' për De Ligtin

Sipas gazetës spanjolle "Sport", Manchester Unitedi i ka ofruar kapitenit të Ajaxit, Matthijs de Ligtit, një ofertë marramendëse, përfshirë këtu pagën prej 14 milionë eurosh për vit, apo 270 mijë eurosh në javë. Më herët ishte raportuar se De Ligt është shumë afër marrëveshjes me Barcelonën, por kjo ofertë mund t'i ndryshojë gjërat. Unitedi po kalon nëpër një krizë dhe nuk do të luajë në Ligën e Kampionëve sezonin e ardhshëm dhe synim ka transferimin e shumë lojtarëve. Në rast të transferimit në "Old Trafford", De Ligtin në kontratë do t'i përfshihen edhe shumë bonuse, përfshirë këtu bonuse për çdo paraqitje, çdo gol e çdo asistim.

Lippi rikthehet në stolin e Kinës

Ish-trajneri i Juventusit dhe Italisë, Marcello Lippi, zyrtarisht është riemëruar trajner i Kombëtares së Kinës. Lippi e liron pozitën e tij gjatë muajit janar pas eliminimit të Kinës nga Kupa e Azisë dhe zgjodhi bashkëkombësin e tij Fabio Cannavaro si pasardhës. Megjithatë, u konfirmua të enjten mbrëma se 71-vjeçari kishte kthyer frenat e ekipit kombëtar pasi Cannavaro vendosi të përqendrohet në klubin kryesor kinez, Guangzhou Evergrande. Lippi fitoi 13 ndeshje, barazoi tetë dhe humbi 11 nga 31 ndeshjet e tij gjatë periudhës së tij të parë me kombin aziatik. Italiani gjithashtu ka një karrierë të bujshme duke fituar shumë trofe me ekip si Juventus, ndërsa kulmi ishte Kupa e Botës me Italinë më 2006.

Toronto, afër titullit në Konferencën e Lindjes


MILWAUKEE, 24 MAJ - Toronto fitoi ndaj Milwaukee në finalen e pestë të "play-off"-it në Konferencën e Lindjes (105-99), duke udhëhequr 3-2 serinë e ndeshjeve finale. Edhe pse Milwaukee luajti në fushën e saj, nuk arriti të përfitojë nga faktori fushë dhe tashmë e sheh veten në disavantazh. Në fakt, skuadra vendëse dominoi në ndeshje në shumicën e kohës, duke u shkëputur deri në 14 pikë, por në periodën e fundit erdhi përmbyssa e miqve. Antetokounmpo realizoi 24 pikë dhe Bledsoe 20, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Në kahun tjetër, shkëlqeu Leonardo, autor i 35 pikëve, lider në fushë për kanadezët. Milwaukee, që fitoi dy finalen e para, tashmë e sheh veten në disavantazh, pasi kanadezët fituan tri takimet e radhës dhe janë një fitore lart titullit kampion në



KONFERENCA E LINDJES - FINALE "PLAY-OFF"
Milwaukee - Toronto 99-105 (2-3)

Lindje. Madje Toronto do ta luajë ndeshjen e radhës në fushën e tij. Në Perëndim, kampion është

shpallur ekipi i Golden State, që pret ta mësojë emrin e finalit për titullin kampion në NBA.



		Autor: GAZMEND MORINA	VENDOSJA E DIÇKAJE NË NJË VEND	VIJË E HAPUR NGA UJËRAT E SHIRAVE	ERA E KËNDSHME	AKTORI AMERIKAN RICHARD (shqip.)	PËRCAKTIMI I NUMRIT RENDOR TË REGJISTRIT; REGJISTRIMI	ZANORE	PËRFUNDIMI TEORIK, QË NXIRRET NËPËRMJET PËRFUNDIMIT SHKENCOR	SHKOJ, ECI (bised.)	VLERË, DOBI (krah.)	EPOKA ERE	PRODUKT ZJARRI
		QË PRANON SI TË VËRTETË VETËM ATË QË ËSHTË E DOBISHME										BASHKËT. PERSON QË KA PASION PATOLOGJIK VENIEN E ZJARREVE	
		KLUB I YNI FUTBOLLI						SKUADRA SPORTIVE I GJYMTUAR					
		ZBUTJA OSE DOBËSIMI I NJË LËKUNDJE A GODITJE											BISKOTË E GATUAR ME ARRA (sh.shq.)
		BASHKËT.		KËNGËTARJA KËRÇELI I ÇMPREH						EPOKË (shq.) ADEM JASHARI			
		AKTORJA AMERIKANE FARROW				DY ZANORE MA JEP			GRIMCA MË E IMËT E ÇDO ELEMENTI				
		ALBERTO TOMBA			AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT BASHKËT.				JEMENI REOMIR, IRIDIUM		MARC ANTHONY MUZIKANTI KRASNIQI		
		QË BËHET SIPAS NJË NORME TË CAKTUAR; I								DRU MESDHETAR			
EPOKA ERE	ISH FUTBOLLISTI ANGLEZ BECKHAM	MODELJA JONË NË FOTO ÇUNMULAJ	SUPER MODELJA AMERIKANE CRAWFORD (shqip.)	PASIMI (Sport)	OKSIGJEN, NEON	ISMET PEJA "N" pas dy "T"		GJASHTARE PËRGËZIM			NËNË (krah.) QYTET NË MAQEDONI		
	SUNDIMTAR ME PUSHTET ABSOLUT E TË PAKUFIZUAR	○					DY ZANORE		I PJEKURI; I MATURI KËNGËTARJA PERUANE ... SUMAK			BASHKËT. PRAPAVEP-RUESE	
	LLOJ MINERALI QË PËRDORET PËR PLLAKA IZOLIMI	○					BURRA TË GUXIMSHËM DERA E VOGËL E THURUR ME THUPRA			FUTBOLLISTI ULIKS QË KA TË BËJË ME ILIRËT DHE ROMAKËT			
	AKTORI FRANCEZ CASSEL (shqip.)	○					INVA MULA DY (turq.)		RITUAL TEFIK OSMANI		ELIZABETH TAYLOR SELEN		
	SHTET I MADH NË AZI	○			FUTBOLLISTI BAJRAMI (TWENTE)	VARGJET E PËRPTHURA SHAMATA				HUMBUR (ang. orgj.) NOTË MUZIKORE			I ÇMENDUR
	BURRË TRIM E BUJAR	○		I EPIKËS PRAROJ			FUTBOLLISTI ARGJENTINAS PABLO (BENFICA)		HISTORIANI ZVICERAN SCHMITT (shq.) KRIMB I DRURIT				
EPOKA ERE	GAZETARJA SHQIPTARE TARE	LLOJ SHEQERKE	LLOJ GAZI ME ERË TË KEQE E TË FORTË VEGËL MUZIKORE (sh.shq.)						TOKA E BUKËS REGJISORI QOSJA		OLIVER KAHN DY BASHKËTINGËLLORE		
	I TURPËROVA						AXHAMI SMALTI		ZANORE KOHË KUR NIS TË ZBARDHË DITA (sh.pashq.)		ILAÇ		
	KTHESEË RRUËGË OSE LUMI						I DËRGUAR SPECIAL EMËR FEMRE MYSLIMANE				MJET PËR TË RRËSHQITUR MBI BORË BASHKËT.		
	MBYS DIKË ME ARMË ZJARRI				KËNGËTARJA VALENTINA KUDRET ISAI				NIS TË ZBARDHË DITA ELIZA HOXHA		DY BASHKËTINGËLLORE SHKRONJA XVIII		
	"R" pas dy "A"			VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE SILIC					ISMET MUNISHI KRYEMURG		BREJTËSI I VOGËL RYSHFET		
EPOKA ERE	FEMRA E ZGJEDHUR HARK, KTHESEË					IRMA LIBOHOVA TRUP GJEOMETRIK		BANJË ALLATURKA NDËRTIM ME TË CILIN RRETHOJMË OBORRIN			VENEZIA, ROMA KRAHINË NË SHQIPËRI		
	ROKERI AMERIKAN KRAVITZ (shqip.) FORTESEË				VEPËR E KRIMINELIT RIFAT ISMAJLI			KUNDREJT MALLKIME "RISANI"					TEFTA TASHKO
				RETURN ON EQUITY BASHKËT.			GODINA MBI UJË BASHKËT.		SHKRONJË GREKE AUSTRIA		TOTENHAM ZANORE		
	AKTORJA HOLIVUDIANE ZETA JONES (shqip.)						KLUB I YNI FUTBOLLI			PEZMATIM I VESHIT			

Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo – Tax Administration of Kosovo

NJOFTIM I SHITJES ME ANKAND PUBLIK
NOTICE OF PUBLIC AUCTION SALE
OBAVEŠTENJE O PRODAJI U JANU LITCITACIJU

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34 Mbledhja e Detyruar e Tatimit, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit.
Under the Law 03/L-222, Article 34 Enforcement Collection of tax, the property described below has been seized for nonpayment of taxes due
Na osnovu Zakona Br.03/L-222 Član 34 Prinudna Naplata Poreza, dole navedena imovina je zaplenjena zbog ne naplate poreza.
Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të hapura sikurse është rregulluar në Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Udhëzimin Administrativ nr. 15/2010, Neni 37
The property shall be sold by sealed bid auction as provided on "Law 03/L-222 on Tax Administration and Procedures", Article 37
Imovina prodacë se licitacijom zatvorenim ponudama kako je to regulisano u Zakonu Br. 03/L-222, o Poreskoj Administraciji i Procedurama, Član 37.

DATA E SHITJES/DATE OF SALE:/ DATUM PRODAJE: **06.06.2019 (Ejte)**
Koha e shitjes/TIME OF SALE/ VREME PRODAJE: Ora 11:00
Vendi i shitjes/PLACE OF SALE/ MESTO PRODAJE: Depoja e ATK-ës (Objekti i Reformës) në Shkabaj Ish. Orloviçë

Përshkrimi i pasurisë/ Description of property/ Opis imovine:

1. Automjet GOLFF -03 1.9 viti prodhimit 1993, data valide e regjistrimit deri 10.12.2019 e Kuqe
1. Automjet GOLFF -04 1.9 viti prodhimit 2003, data valide e regjistrimit deri 11.09.2019 e Zezë
1. Automjet GOLFF -05+ 1.9 viti prodhimit 2008, data valide e regjistrimit deri 12.11.2019 e Kaltër

Shitja e mallrave në Grup(ters) Oferta fillestare 7500.00

Kushtet e pagesës: Kërkohe pagesa e tërësishme me pranimin e ofertës më të lartë. Të gjitha pagesat duhet të bëhen me transfer bankar në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.
Payment terms: Full payment required upon acceptance of highest bid. All payments must be made by bank transfer to Kosovo Consolidated Budget.
Uslovi naplate: Traži se celokupna naplata primenjem najveće ponude. Sve isplate treba da se vrše bankarskim transferom u Konsolidovani Budžet Kosova.

Informata shtesë lidhur me gjendjen e mallrave dhe shikimin e tij mund të kontaktoni zyrtaret e autorizuar të ATK-ës në tel. 044354323; 028533648/ prej orës 08h-16h.

For additional information with regard of goods' conditions and their review can be contacted the authorized TAK officials on tel. 044354323; 028533648, from 08:00 a.m. 04:00 p.m.

Za dodatne informacije u vezi uslova robe i njihovo razmatranje se može kontaktirati nadležne PAK zvaničnike tel. 044354323; 028533648, od 08:00 - 16:00.

ATK-ja nuk merr përgjegjësi dhe rrezik për përfundimet dhe interpretimet e nxjerra nga cilido ofertues, për dokumentacionin e siguruar nga agjencionet kadastrale.

TAK shall not take any responsibility and risk for the conclusions and interpretations extracted by any bidder, for the documentation secured from the cadastral agencies.

PAK ne preuzima nikakvu odgovornost i rizik za zaključke i tumačenja izvađenih od bilo kog ponuđača, za dokumentacije obezbeđena iz katastarskih službi.

Nënshkrimi i Drejtorit Regional / _____ Data / Date/ Datum: 24.05.2019

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS-MALISHEVË

Zyra e Personelit
Nr.01/698
Më:24/05/2019

Në mbështetje të dispozitave të nenit 11, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 15 dhe 17 të Rregullores Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëchqesi i Personelit shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të punës


I. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE
1.(Një) Zyrtar për Kujdesin ndaj Personave me Aftësi të Kufizuara,
Kushtet: Kualifikimi diplomë e Universitetit, Bachelor- Drejtimi Sociologji, Psikologji.
Përvojë pune: 4 vite përgatitje profesionale.
Koeficienti: 5
Kodi i vendit të punës MSK/090

Përshkrimi i detyrave të punës:
1. Në bashkëpunim me shefin menaxhues të QKMF-së përcjellë punën e Institucioneve shëndetësorë;
2. Përcjellë punën e barnatores në QKMF-së, furnizimin më barna, mënjanimin e barnave në Institucione Shëndetësorë të cilave u ka skaduar afati;
3. Në bashkëpunim me zyrtarin për buxhet dhe shërbimin juridik pran QKMF-së çdo muaj përgatitë raportet financiare dhe të dhënat mbi pacientet dhe dërgohen në autoritetin e qarkut në Prizren;
4. Në kuadër të aktivitetit rreth shëndetit publik në bashkëpunim me Inspektorin komunal sanitar dhe më udhëheqësin e shërbimit të vaksinimit pran QKMF-së përcjellë situatën epidemiologjike siç janë: higjiena e ujit të pijshëm, suksesi i imunizimit të fëmijëve etj;
5. Në bashkëpunim me autoritetet regionale për shëndetin mental dhe Qendrën për Punë Sociale në Malishevë përcjellë dhe i koordinon aktivitetet në leminë e shëndetit mental: vizitat e pacienteve në Q.S.H.M. në Gjakovë hospitalizimet e pacienteve si dhe terapia shtëpiakë mujore e të gjithë pacienteve.
6. Kohë pas kohe bën vizita edhe neper njesi të tjera të QKMF-së në teren ku Inspektohet puna e gjithë mbarshme e punëtorëve;
7. Kryen edhe punë të tjera sipas urdhrat të drejtorit;

Kushtet:
-Diploma e përgatitjes profesionale;
-Letërnjoftimi (fotokopje);
-certifikata e lindjes;
-certifikata për trajnimet e kryera;
-Dëshmi qe nuk është nën hetime
-Vërtetimin e përvojës së punës;
Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në **Zyrën për pritjen e palëve** të KK- Malishevë. Aplikantët janë të obliguar që t'i parashirojnë edhe këto dokumente: diplomën e shkollimit, Vërtetimin mbi përvojën në punë.
Konkursi do të mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së tij në të përditshme: "Epoka e re" dhe në tabelë të shpalljeve të **KK- Malishevë**.

Për intervistë do të njoftoheni me kohë.

Udhëheqesi i Personelit
Gani Bahtjaraj, jur.dipl.

**NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.**
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Prishtina, Kosova
